



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 210 Akti

**Nr. 220 Vendimi
Tiranë, më 10.12.2019**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në datën 3.12.2019, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N :

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Fatri Islamaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*. Z. Fatri Islamaj u zgjodh me short anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe iu nënshtroa procesit të rivlerësimit me përparësi, mbështetur në nenin 179, pika 11, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, u shortua në datën 15.11.2018. Relatore e çështjes u zgjodh sipas shortit komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje anëtarin Lulzim Hamitaj. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Hans Kijlstra.

3. Në datën 21.11.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.

4. Në datën 23.11.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura në datën 7.11.2019, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht mbështetur në të tria kriteret e vlerësimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Fatri Islamaj dhe mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen në datën 9.11.2019 dhe dërgoi me anë të postës elektronike në datën 20.11.2019, kundërshtimet dhe prova e tij për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit.

9. Komisioni ftoi në datën 22.11.2019, subjektin e rivlerësimit, në seancë dëgjimore në datën 3.12.2019. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 3.12.2019, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

11. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit Fatri Islamaj, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka refuzim për deklarim;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

12. Pavarësisht se sipas KREU-t IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit Nr. 2/2017², të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

13. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri.

14. Apartament banimi ndodhur në Rr. “***”, Tiranë, blerë në vlerën 10.548.500 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) lekë, me kontratë sipërmarrjeje për prentim apartamenti, datë 18.3.2016.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se është nënshkruar kontrata e shitblerjes³ e datës 30.8.2017 për apartamentin, duke iu referuar pasurisë së mësipërme. Subjekti shprehet se lloji i pasurisë sipas projektit është “njësi” por i blerë me qëllim apartament banimi.

15. Burim i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar kontrata e kredisë bankare,⁴ datë 24.3.2016, lidhur me “Credins Bank”, për financimin e vlerës 10.500.000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë.

16. Referuar kontratës së sipërmarrjes për prentim apartamenti të datës 18.3.2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “***” sh.p.k., pasurinë e llojit ambient nr. 12, me sipërfaqe totale 144.5 m², nga të cilat 122.7 m² janë sipërfaqe të shfrytëzueshme, në të cilën përfshihet edhe 8 m² ballkon, ndodhur në katin e parë (i dyti nga toka).

17. “Credins Bank”⁵ konfirmon se subjekti i rivlerësimit në datën 24.3.2016 ka lidhur kontratën⁶ e kredisë bankare, sipas së cilës banka në cilësinë e palës kredidhënëse bie dakord që t’i japë kredimarrësit, z. Fatri Islamaj, një kredi në vlerën 10.500.000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë, me qëllim kredi hipotekore për blerje apartamenti. Kjo kredi do të përdoret vetëm për qëllimin e parashikuar në kontratë i cili nuk mund të ndryshojë apo t’i transferohet të tretëve.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”, dhe konkretisht dokumentit “nxjerrje llogarie” për llogarinë me nr. *** në emër të z. Fatri Islamaj, rezulton se në këtë llogari në datën 25.3.2016 është *disbursuar* kredia në vlerën prej 10.462.200 (dhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh. Po, në datën 25.3.2016, z. Fatri Islamaj, ka transferuar vlerën prej 10.548.500 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) lekësh në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “sipas kontratës nr. ***”.

Rezultoni se në datën 22.1.2018 midis “Credins Bank” dhe subjektit të rivlerësimit është lidhur kontrata e hipotekës⁷, me objekt krijimin e hipotekës së radhës së parë për të garantuar shlyerjen e plotë të detyrimeve deri në vlerën e parashikuar në kontratën e kredisë dhe/ose çdo ndryshim të kësaj kontrate (sipas nenit 1.3) plus interesat, penalitetet, dëmet dhe shpenzimet mbi pasurinë e hipotekuesit: pasuria me certifikatë pronësie lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të

²“41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoni se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

³ Kontrata nr. ***, datë 30.8.2017.

⁴ Kontrata nr. ***, datë 24.3.2016.

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.2.2019; dhe shkresa nr. *** prot., datë 27.8.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.8.2019.

⁶ Kontrata me nr. ***, datë 24.3.2016.

⁷ Kontrata me nr.***, datë 22.1.2018.

Paluajtshme Tiranë, me nr. pasurie ***, e ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “njësi”, me sipërfaqe totale 123 m², me adresë në Rr. “***”, Tiranë, në pronësi të shtetasit Fatri B. Islamaj.

Nga analizimi i dokumentacionit dhe i të dhënave të mësipërme duket se në favor të subjektit është lëvruar/*disbursuar* kredia nga “Credins Bank” me mbulim 100 % të vlerës së investimit, para nënshkrimit të kontratës së hipotekës.

18. Lidhur me këtë fakt, subjekti i është kërkuar të japë shpjegime dhe, po ashtu, është hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi gjatë ushtrimit të funksionit të tij si gjyqtar.

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera shpjegoi se⁸ – ... është kredituar nga banka në masën 100 % të vlerës së blerjes së apartamentit dhe se në marrëveshjen që është bërë me bankën është përcaktuar që vetë ky apartament do shërbente si mjet sigurimi për shlyerjen e kredisë bankare.

Në vijim subjekti sqaron se ... i gjithë objekti ka qenë i regjistruar më parë në ZVRPP dhe banka ishte siguruar për këtë fakt dhe për faktin se ky apartament ishte porositur vetëm nga ai si kredimarrës i ardhshëm. Gjithashtu, në marrëveshje me bankën ishte rënë dakord që sapo objekti do të regjistrohej në ZVRPP dhe të dilte certifikata e pronësisë, do të bëhej menjëherë dhe kontrata e hipotekës si garanci formale e bankës.

Veprimet janë bërë sipas dispozitave standarde të bankës dhe nuk ka pasur trajtim preferencial. Referuar kontratës së kredisë, banka ka pasur dhe garancinë e institutit të dorëzarisë në këtë kontratë, ku qoftë ai si debitor, qoftë dorëzanesja (bashkëshortja) kanë pasur detyrimin që si mjet sigurimi për këtë kontratë kredie të shërbejë çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme, e tashme dhe e ardhshme e tyre.

Lidhur me pyetjen e bërë nga Komisioni, nëse ka zhvilluar çështje gjyqësore me palë “Credins Bank”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se – nga momenti që ka nënshkruar kontratën e kredisë me këtë bankë në muajin mars të vitit 2016 dhe në vazhdim ka vlerësuar me ndërgjegjen e tij për të mosgjykuar çështje themeli ku palë ndërgjygjëse që tërheq të drejta apo detyrime nga vendimi i gjykatës (paditës ose i paditur) ka qenë “Credins Bank”.

Në vijim subjekti ka sqaruar se – *praktika gjyqësore dhe jurisprudenca në gjykatat shqiptare nuk e ka konsideruar si konflikt interesi këtë situatë dhe kur para gjyqtarëve janë paraqitur çështje themeli ku njëra palë në konflikt ka qenë banka që gjyqtari apo bashkëshortja/bashkëshorti kanë marrë kredi (cituar vendimi nr. 41, datë 10.10.2013, i Gjykatës Kushtetuese).*

19. Bazuar në kërkesën⁹ e dërguar nga Komisioni, Gjykata e Apelit Tiranë na informon¹⁰ se nga verifikimi i sistemit *ICMIS* të kësaj gjykate, rezulton se gjyqtari Fatri Islamaj, deri në datën 9.10.2019, nuk ka gjykuar si relator asnjë çështje gjyqësore me palë ndërgjygjëse shoqërinë “Credins Bank”, ndërsa si anëtar i trupit gjykues ka gjykuar vetëm një çështje gjyqësore. Bashkëlidhur ka dërguar kopje të vendimit nr. ***, datë 8.3.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Nga verifikimi i këtij vendimi konstatohet se shoqëria “Credins Bank”, nuk ka qenë në cilësinë e palës paditëse apo palës së paditur në këtë çështje gjyqësore, por në cilësinë e personit të tretë. Ky vendim është cituar edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, referuar si më sipër.

20. Komisioni vëren se pasuria e mësipërme është identifikuar në mënyra të ndryshme, në kontrata të ndryshme dhe në deklarimet e subjektit (njësi/apartament).

Lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit shpjegoi¹¹ – *lidhur me destinacionin e kësaj pasurie të paluajtshme të blerë nga ana e tij, e cila në projekt teknik të objektit, rezulton e kategorisë njësi shërbimi, është blerë me destinacion për ta përdorur si apartament banimi. Që në momentin e parë të shprehjes së vullnetit për të porositur këtë pasuri, në kontratën e*

⁸ Përgjigjet e pyetësorit, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 8.10.2019.

¹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 10.10.2019.

¹¹ Përgjigjet e pyetësorit, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

sipërmarrjes të datës 18.3.2016 titullohet “kontratë sipërmarrje – prenotim apartamenti”. Më tej, ndryshimet në terminologji janë gabime materiale të noterit që e ka hartuar pjesën tjetër.

Ky fakt konstatohet edhe në kontratën e kredisë nr. *** rep., datë 24.3.2016, me të cilën siç është sqaruar, është bërë i mundur dhe pagimi i të gjithë vlerës së kësaj shpërfaqjeje. Në nenin 2, pika 1, të saj përcaktohet qëllimi i kredisë hipotekore “blerje apartamenti”.

Subjekti shpjegon se për sa i përket vullnetit të tij si blerës ka qenë gjatë gjitha kohës i shprehur qartë, dhe konsequent në çdo hap që nga kontrata e parë, ajo e sipërmarrjes e deri tek kontrata e fundit e shitblerjes e cila e cilëson këtë sipërfaqe për qëllim banimi.

21. ZVRPP-ja Tiranë¹² konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë njësi me sipërfaqe 123 m². Në seksionin e hipotekave është regjistruar shënimi: “bllokohet në favor të ‘Credins Bank’, për vlerën 10.500.000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë, siç është parashikuar në kontratë hipoteke.”

22. Komisioni mori në analizë edhe vlerën e paguar për blerjen e kësaj pasurie. Referuar udhëzimit nr. ***, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave për vitin 2015”, konstatohet sipas tabelës 3 të këtij udhëzimi se të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2015 për zonën “***” është në vlerën 75.000 lekë/m².

23. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se subjekti e ka blerë këtë pasuri me çmimin prej 73.000 lekë/m² (10.548.500 lekë /144.5 m², duke përfshirë edhe ambientet ndihmëse). Rezulton se çmimi i blerjes së pasurisë si apartament nuk është brenda kufijve mesatarë të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për zonën “***”¹³.

24. Nisur nga fakti se në kartelën e pasurisë kjo pasuri është e regjistruar si njësi tregtare, i jemi drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,¹⁴ duke i kërkuar informacion mbi vlerën mesatare të shitblerjes për njësitë në këtë zonë, si dhe kontrata të ngjashme sipërmarrje ose shitblerje për njësitë e tjera të shitura në këtë objekt.

25. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri¹⁵, ka dërguar kontratat e regjistruara për shitjet e njësive në objektin ku ndodhet dhe pasuria e subjektit të rivlerësimit, të dhënat përmbledhëse të të cilave pasqyrohen, si më poshtë:

Nr.	Kontrata	Nr. pasurisë	Sipërfaqja	Vlera	Çmimi/m ²
1.	k. sh., datë 3.12.2018	***	103 m ²	10.760.951 lekë	104.475 lekë /m ²
2.	k. sh., datë 8.12.2018	***	96 m ²	10.500.000 lekë	109.375 lekë/m ²
3.	k. sh., me kusht, datë 19.12.2016	***	56 m ²	140.000 euro	2.500 euro/m ²
4.	k. sh., datë 29.8.2017	***	(njësi 105 m ² + verandë 128 m ²)	12.000.000 lekë	
5.	k. sh., datë 30.8.2017	***	89 m ²	2.500.000 lekë	28.089 lekë/m ²
6.	k. sh., 2017	***	20 m ²	3.000.000 lekë	150.000 lekë/m ²
7.	k. sh., datë 3.3.2019	***	124 m ²	23.113.500 lekë	26.399 lekë/m ²

26. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, informon se për sa i përket vlerës mesatare të shitblerjes për z. k. ***, nr. pasurie ***, çmimi është në vlerën 77.000 lekë/m² – në rastin kur pasuria kualifikohet si njësi tregtare. Duket se çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti i rivlerësimit nuk është brenda kufijve mesatarë të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave, për zonën “***”, si dhe nuk është as i përafërt me çmimin e tregut të rezultuar nga kontrata të ngjashme.

27. Mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar: (1) a ka pasur ai një çmim favorizues në blerjes së kësaj pasurie; dhe (2) a ka përfituar trajtim

¹² Shkresa nr. *** prot., datë 17.1.2019.

¹³ Sqarojmë këtu se kontrata e sipërmarrjes është lidhur në datën 18.3.2016, ndërsa udhëzimi për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016 është i datës 28.12.2016.

¹⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 12.7.2019.

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 13.9.2019.

preferencial nga “Credins Bank” për marrjen e kredisë nisur nga kolaterali i vendosur, dhënia e vlerës 100 %, si dhe norma e interesit.

28. Në shpjegimet e tij subjekti ka deklaruar se çmimi i blerjes së apartamentit nuk është favorizues, madje është ndjeshëm mbi vlerat mesatare të zonës ku ndodhet. Referuar kontratës përfundimtare të shitblerjes dhe certifikatës së pronësisë sipërfaqja e kësaj prone është 123 m². Ndërsa çmimi i blerjes në total ka qenë në vlerën 10.548.500 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) lekë, dhe rezulton se çmimi i blerjes për metër katror ka qenë në vlerën 85.760 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë (10.548.500 lekë/123 m²).

Subjekti, për të vlerësuar nëse ka të bëjë me një çmim favorizues, duhet të krahasojë çmimin e shitjes me koston që ka ndërtuesi për të ndërtuar këtë pasuri. Është konstatuar lehtësisht që çmimi i blerjes se këtij apartamenti nga subjekti është shumë herë më i lartë sesa kostoja e ndërtimit të këtij apartamenti, si rrjedhim, nuk mund të konsiderohet që subjekti ndërtues ta ketë favorizuar në asnjë rrethanë subjektin e rivlerësimit. Sipas Udhëzimit Nr. ***, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2015”, ka vendosur: “*Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, në shkallë republike, për vitin 2015, e cila të jetë 39.587 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi*”.

29. Subjekti ka shpjeguar se në të njëjtat kushte me të janë edhe disa fqinjë të tij të cilët kanë blerë shtëpinë në të njëjtin kat dhe e përdorin për banim, duke paraqitur:

- deklaratë noteriale të shtetasit F. M., pronar i apartamentit nr. *** (shiko në tabelën më lart, pasuria nr. 1), nga ku rezulton se ka blerë në të njëjtin kat me subjektin e rivlerësimit një pasuri me sipërfaqe 103 m², me çmimin 10.760.951 (dhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë, klasifikuar si “njësi” dhe për ta përdorur si apartament. Për të provuar këtë fakt ka paraqitur foto të ambienteve të shkallës dhe të ambienteve të brendshme të apartamentit dhe certifikatë pronësie të datës 28.12.2018, ku evidentohen të dhënat më lartë, si dhe kontratë shitblerje të kësaj pasurie me nr. *** rep., datë 3.12.2018;
- deklaratë noteriale të shtetasit B. M., pronar i apartamentit nr. *** (shiko në tabelën më lart, pasuria nr. 2), nga ku rezulton gjithashtu se ka blerë në të njëjtin kat me subjektin e rivlerësimit një pasuri me sipërfaqe 96 m², me çmimin 10.500.000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë, klasifikuar si “njësi” dhe për ta përdorur si apartament. Për të provuar këtë fakt ka paraqitur foto të ambienteve të shkallës dhe të ambienteve të brendshme të apartamentit dhe certifikatë pronësie të datës 3.1.2019, ku evidentohen të dhënat më lartë, si dhe kontratë shitblerje të kësaj pasurie me nr. *** rep., datë 8.12.2018.

30. Lidhur me konstatimin e Komisionit për trajtim preferencial nga “Credins Bank” subjekti ka sqaruar se: “... nuk rezulton që të kem gjykuar ndonjë çështje gjyqësore ku si palë ndërgjyqëse (paditës apo i paditur) të ketë qenë “Credins Bank”, ku kam marrë kredinë. Në këto kushte provohet plotësisht fakti që unë nuk jam në konflikt interesi me këtë subjekt.

Për sa i përket mjetit të sigurimit (kolateralit) të kësaj kredie nga ‘Credins Bank’, unë nuk kam bërë asnjë kërkesë të posaçme për ndonjë trajtim favorizues. Nuk është përgjegjësi e imja si subjekt deklarimi, procedura brendshme e ndjekur nga ‘Credins Bank’ në lëvrimin e kësaj kredie dhe aplikimit nga banka për regjistrimin në kohë apo jo të mjeteve të sigurimit për kredinë. Kam parasysh këtu që banka ka pasur në dispozicion kontratën time të sipërmarrjes para se të lidhej kontrata e kredisë, dhe si rrjedhim, në përputhje me ligjin për barrët siguruese dhe qëllimi që ia kam vënë në dispozicion këtë kontratë ka qenë pikërisht që të regjistronte barrë siguruese në regjistrin përkatës RBS, si dhe në ZVRPP.

Për sa i përket normës së interesit me të cilin banka më ka akorduar kredinë, referuar nenit 5 të kontratës së kredisë rezulton se banka më ka akorduar këtë kredi me një normë interesi vjetor 3 % për vitin e parë dhe në vazhdim banka ka rezervuar të drejtën të rrisë këtë normë interesi në varësi të normave të tregut, sipas nenit 5.8 të kontratës rezulton se banka ka parashikuar mundësinë e rritjes së normës së interesit deri mbi 5 %.

Madje edhe me një kërkim në internet rezulton që edhe banka të tjera kanë norma të ngjashme interesi për kreditë e banesave, siç rezulton dhe nga informacionet publicitare të tyre. Është e qartë që nga kjo marrëdhënie kredie banka realizon një aktivitet fitimprurës, ndërsa unë si kredimarrës kam një kosto të konsiderueshme për shkak të përdorimit të shumës së kredisë në një periudhë të gjatë kohë për 20 vite nga data e disbursimit”.

Nuk vlerësoj se kam pasur një trajtim preferencial të cilin duhet ta kisha deklaruar në kuptim edhe të nenit 2, pika 10, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarinin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, nën titullin “përkufizime”, ku thuhet shprehimisht se: “Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 10. “Trajtime preferenciale” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, asetet, shërbimet, mallrat ose përfitime të tjera të ngjashme që i jepen ose janë në përdorim nga personi, pa shpërblim, si pasojë e detyrës, marrëveshjeve ose kontratave.”

Subjekti sqaron se aga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se që të jemi përpara një trajtimi preferencial duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: (i) subjektit të deklarinimit duhet t’i jepen shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme, të cilat mund të jenë edhe në përdorim të tij; (ii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t’i jepen subjektit të deklarinimit për shkak të detyrës së tij; dhe (iii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t’i jepen subjektit të deklarinimit pa shpërblim.

Funksioni kryesor i bankës që gjeneron të ardhura është të japë kredi dhe këtë shërbim ia ofron çdo personi që plotëson kushtet e vendosura prej saj. Ndodhur në këto kushte konstatohet lehtësisht se nuk plotësohen në mënyrë kumulative kushtet për të qenë në kushtet e një trajtimi preferencial.

31. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklarinimet periodike vjetore lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit dhe për kredinë e marrë për blerjen e tij, dhe se shpjegimet e dhëna dhe provat e paraqitura përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe me deklarinimet e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese dhe me bankën ishte një marrëdhënie personale/private e cila ishte e ngjashme edhe me kontrata të tjera për sa i përket çmimit të blerjes edhe për sa i përket dhënies së kredisë në masën 100 % të vlerës ajo është një marrëdhënie negociimi e pranuar nga palët.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se këto fakte që rezultuan nga hetimi administrativ i Komisionit nuk mund të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

32. Pasuria e llojit autoveturë, tip “Toyota Camry”, vit prodhimi 2005, me targa * blerë në datën 23.1.2017, për vlerën prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.** Subjekti ka deklaruar se zotëron 50 % të kësaj pasurie. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet nga pagesat e mësimdhënies në Universitetin Europian të Tiranës, të deklaruara në “Credins Bank”.

33. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor¹⁶ konfirmon se subjekti ka në pronësi të tij mjetin me targa ***, duke dërguar dosjen e automjetit¹⁷.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj dosjeje rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 23.1.2017 këtë automjet e ka blerë¹⁸ nga vëllai i tij, z. F. I., kundrejt vlerës 200.000 (dyqind mijë) lekë. Në kontratën e shitblerjes së këtij mjeti përcaktohet se palët deklarojnë se pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale pa pretendime nga palët.

34. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, konstatohet se në kontratën e shitjes së këtij automjeti çmimi i përcaktuar është në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Rezulton se edhe në deklaratën periodike

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 9.1.2019.

¹⁷ Për më tepër shihni në dosjen e ILDKPKI-së shkresën me nr. *** prot., datë 16.1.2019, të DPSHTRR-së.

¹⁸ Kontrata nr. ***, datë 23.1.2017.

vjetore të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka blerë këtë automjet në vlerën prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

35. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të dërguar nga “Credins Bank”¹⁹ rezulton se në datën 23.1.2017, nëpërmjet llogarisë me nr. *** (llogari ku janë kredituar pagat nga Universiteti European i Tiranës), subjekti i rivlerësimit ka transferuar vlerën 1.800 (një mijë e tetëqind) euro (konvertuar në vlerën 239.310 [dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e dhjetë] lekë²⁰) në favor të z. F. I., (vëllait të tij), me përshkrimin “*kalim për blerje makine Toyota*”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3²¹, subjekti deklaroi se vlerën e mbetur prej rreth 10.000 (dhjetë mijë) lekësh ia ka dhënë dorazi vëllait të tij.

36. Subjekti ka shpjeguar se për sa i përket mospërputhjes në ekzemplarët e ndryshëm të kontratës së blerjes, kjo buron nga lapsusi apo gabimi material i noterit, i cili ka përpiluar kontratën e shitblerjes. Subjekti në deklaratën “Vetting” ka bërë deklarinimin të saktë, me çmimin më të lartë 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, i cila përputhet edhe me provat e paraqitura dhe transfertën bankare të kryer.

37. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me provat e paraqitura.

38. Gjendje cash në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë nga kursimet. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat nga pagat si gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe honoraret e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës.

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016 konstatohet se subjekti ka deklaruar gjendjen cash vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh nga kursimet.

39. Nga analiza financiare e kryer²², subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kursimeve cash në vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh në fund të vitit 2016 – si rrjedhim edhe për të justifikuar krijimin e kësaj shumë në datën 25.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”).

Gjendjet në llogaritë bankare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

40. Kursime në vlerën 14.600,36 (katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind, presje tridhjetë e gjashtë) lekë, në “Credins Bank”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat nga pagat të mbetura në llogarinë rrjedhëse. Subjekti deklaroi se zotëron 50 % të kësaj pasurie.

“Credins Bank”²³ konfirmon se subjekti zotëron llogarinë bankare nr. *** (llogari page), me gjendje në vlerën 14.600 (katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë, në momentin e deklarinimit.

41. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

42. Kursime në vlerën 2.003,58 (dy mijë e tre, presje pesëdhjetë e tetë) euro, në “Credins Bank”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursime nga vitet e mëparshme të pashpenzuara, të deklaruara edhe më parë. Subjekti deklaroi se zotëron 50 % të kësaj pasurie.

“Credins Bank”²⁴ konfirmon se subjekti zotëron llogarinë bankare nr. ***, me gjendje në vlerën 2.004 (dy mijë e katër) euro, në momentin e deklarinimit.

43. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

44. Kursime në vlerën 201.393,71 (dyqind e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre, presje shtatëdhjetë e një) lekë, në BKT. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet nga vitet e

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

²⁰ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për periudhën përkatëse.

²¹ Përgjigjet e pyetësorit, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

²² Analiza financiare për vitet 2005 –2016, i bashkëlidhet këtij material.

²³ Shkresa nr. ***prot., datë 12.2.2019.

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

mëparshme dhe mësimdhënia në Universitetin ***. Subjekti deklaron se zotëron 50% të kësaj pasurie.

BKT-ja²⁵ konfirmon se subjekti zotëron llogarinë bankare me nr. *** pranë kësaj banke, e cila në datën 16.1.2017 ka pasur gjendje vlerën 201.393 (dyqind e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton se në këtë llogari janë kredituar pagat nga Fondacioni *** (Universiteti ***). Konfirmohet se gjendja në këtë llogari është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia në Universitetin ***.

45. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

46. Llogari kursimi e hapur në vitin 2005 në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerë 5.52 GBP. “Intesa Sanpaolo Bank”²⁶ konfirmon se subjekti zotëron llogarinë bankare nr. ***, e cila në datën 16.1.2017 ka pasur gjendje vlerën 5.52 GBP.

47. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

48. Nga hetimi ka rezultuar se të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i mësimdhënies kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar në llogaritë e subjektit dhe përputhen me deklaratimet e subjektit, si dhe me dokumentacionin e institucioneve përkatëse.

Pasuri të deklaruara veçmas nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit), znj. M. I.

49. Pasuria e llojit autoveturë, tip “Volvo x60”, me targa ***, vit prodhimi 2009, me vlerë 800.000 (tetëqind mijë) lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie është deklaruar: (i) kursime të personit të lidhur, znj. M. I., në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë; dhe (ii) kursime të subjektit në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Në deklaratën e interesave vjetore periodikë të vitit 2015 personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit), znj. M. I., ka deklaruar se ka blerë një autoveturë të përdorur tip “Volvo x60”, vit i prodhimit 2009, me targa ***, me vlerë 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

50. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor²⁷ konfirmon se bashkëshortja e subjektit, znj. M. I. (L.), ka në pronësi automjetin me targa ***, duke dërguar edhe dosjen e plotë të këtij automjeti.

Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se në datën 29.12.2015 bashkëshortja e subjektit e ka blerë²⁸ këtë automjet nga e motra e saj, znj. E. K., për vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë. Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti rezulton se: në datën 12.6.2014 ky mjet është blerë²⁹ nga shtetasi M. C., për vlerën 13.800 (trembëdhjetë mijë e tetëqind) euro; dhe se në datën 25.6.2014 shtetasi M. C., ia shet³⁰ këtë automjet znj. E. K., në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë.

51. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se – *ka përdorur herë pas here automjetin tip “Volvo x60” me targa *** i cili nga viti 2015 është në pronësi të bashkëshortes së tij dhe se më parë ka qenë në pronësi të motrës së bashkëshortes, znj. E. K.*

Nga informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rezulton se në policat e sigurimit të automjetit të mësipërm subjekti dhe/ose bashkëshortja e tij rezultojnë të jenë shënuar si “përdorues” edhe para blerjes së tij, nga znj. M. I. Edhe nga verifikimi i sistemit TIMS konfirmohet përdorimi i këtij automjeti para se të kalonte në pronësi të bashkëshortes së subjektit.

52. I pyetur nga Komisioni, se si e shpjegon faktin që ky automjet është blerë nga motra e bashkëshortes, nëntë ditë pas blerjes së tij nga shtetasi M. C., dukshëm me një çmim më të ulët

²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.1.2019.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 4.1.2019.

²⁷ Shkresat: nr. *** prot., datë 9.1.2019; nr. *** prot., datë 16.1.2019.

²⁸ Kontrata nr. ***, datë 29.12.2015.

²⁹ Kontrata nr. ***, datë 12.6.2014, dhe fatura tatimore nr. ***.

³⁰ Kontrata nr. ***, datë 25.6.2014.

nga çmimi i shitjes nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit deklaroi se³¹ – *nuk ka informacion rreth kësaj marrëdhënieje dhe se nuk e njeh këtë shtetas. Nga komunikimi me znj. E. K., dhe të shoqin e saj, është informuar se e kanë blerë këtë automjet me një çmim okazional, pasi personi që ia ka shitur nuk e kishte pëlqyer makinën e blerë disa ditë më parë prej tij, për shkak se pas kontrollit të detajuar teknik ka konstatuar manipulim në kilometrazhin e kroskotit (pra, i kishte kilometrat të kthyer).*

Gjithashtu, subjekti ndër të tjera sqaron se – *ky automjet është blerë në datën 29.12.2015 me një diferencë vetëm 20 % më të ulët nga çmimi që shitësja (motra e saj) e kishte blerë rreth një vit e gjysmë më parë – dhe se diferenca në çmim lidhet me uljen e vlerës së tij nga amortizimi i këtij automjeti në kohë, nga përdorimi, si dhe vlerësimit të bërë nga vetë palët në kontratën e shitblerjes në respekt të lirisë së plotë të vullnetit kontraktor.*

53. Referuar pyetjes se Komisionit se si e shpjegon faktin që bashkëshortja e tij ka përfituar pronësinë e këtij automjeti me një çmim rreth 2 herë më të ulët, pas rreth 1 viti e gjysmë mbas shitjes së tij nga subjekti i cili e ka importuar, shoqëria “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit deklaroi se – *mendon se lidhet kryesisht me faktin e konstatimit të manipulimit të treguesit të kilometrazhit, pra, të metat e fshehta të automjetit, si dhe lirisë kontraktore që palët kanë në respekt të vullnetit të tyre dhe dispozitave të Kodit Civil.*

54. Lidhur me pyetjen se cili është burimi i krijimit të kësaj pasurie (automjetit) nga motra e bashkëshortes, subjekti ka vënë në dispozicion shpjegimet e saj (motrës së bashkëshortes) të dhëna nëpërmjet një deklarate noteriale, nga ku pretendon se ajo dhe bashkëshorti i saj, z. P. K., kanë përfituar të ardhura të krijuara nga kursime prej punës 15-vjeçare si emigrant në Greqi. Gjithashtu, sipas vetëdeklarimit ajo dhe bashkëshorti i saj ka qenë gjatë të gjithë kohës në marrëdhënie pune – edhe pasi janë kthyer në Shqipëri edhe gjatë kohës që kanë qenë në emigracion në Greqi (Athinë).

55. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (i pyetur për burimin e krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi P. K., babait të subjektit), subjekti ka paraqitur dokumentacionin fotokopje në gjuhën greke në lidhje me të ardhurat e përfituara në shtetin grek nga z. P. K. Këto të ardhura të pretenduara, subjekti i referon edhe si burim krijimi të pasurisë automjet, blerë prej motrës së bashkëshortes në vitin 2014.

56. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me punësimin e shtetasës E. K., për periudhën 30.3.2011 – 4.11.2013, si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë – për periudhën 4.11.2013 dhe në vazhdim si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë – si edhe dokumentacion që vërteton punësimin e shtetasit P. K., pranë shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, për periudhën 2013 – 2015.

57. Për sa më sipër Komisioni konstaton se: (i) dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shtetasi P. K., në shtetin grek – nuk është në formën e kërkuar nga ligji; (ii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti lidhur me punësimin e shtetasve E. K., dhe P. K., për periudhën 2011 – 2015 – nuk ka dokumentacion lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi.

58. Në vijim të shpjegimeve të tij lidhur me këtë automjet subjekti ka deklaruar se është përdorur nga bashkëshortja e tij edhe kur ishte në pronësi të motrës, znj. E. K., pasi për një periudhë rreth 3 muaj në vitin 2014, si dhe gjatë muajve të parë të vitit 2015 motra e saj ka kaluar një sëmundje të rëndë dhe se bashkëshortja e ka asistuar për nevoja të ndryshme.

59. Në lidhje me transaksionet financiare për blerjen e këtij automjeti, nga shqyrtimi i dokumentacionit administruar në dosje³² rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në vitin 2015 në llogaritë e tyre në “Credins Bank” kanë kryer transaksionet të pasqyruara në tabelën, si më poshtë:

³¹ Përgjigjet e pyetësorit, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

³² Shkresa me nr. *** prot., datë 12.2.2019, nga “Credins Bank”.

Banka	Data	Nr. llogarie	Shuma	Përshkrimi
Credins	28.12.2015	***	201.366 lekë	Tërheqje nga M. I.
Credins	28.12.2015	***	437.000 lekë	Tërheqje nga M.I.
Credins	29.12.2015	***	200.000 lekë	Tërheqje nga Fatri Islamaj
TOTALI			838.366 lekë	

60. Referuar analizës së treguesve financiarë³³ rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e këtyre shumave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës për blerjen e automjetit.

61. Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova të tjera, për burimin e krijimit të kësaj pasurie nga motra e bashkëshortes, duke depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara në shtetin grek, në formën e kërkuar nga ligji, si dhe dokumentacion lidhur me të ardhurat e përfituara në shtetin shqiptar.

62. Subjekti ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se sikurse rezulton nga aktet që Komisioni ka administruar gjatë hetimit administrativ, pasurinë e luajtshme, autoveturë tip “Volvo x60”, me targa ***, bashkëshortja e subjektit, znj. M. I., ia ka blerë motrës së saj. Pra, marrëdhënia juridiko-civile që ka lindur midis tyre është ajo që rrjedhë nga kontrata e shitjes dhe nuk jemi përpara marrëdhënies juridike që rrjedhë nga dhurimi apo huaja.

Subjekti me shpjegimet e tij ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin të legalizuar, përkthyer dhe të noterizuar që provon burimet financiare të motrës së bashkëshortes dhe bashkëshortit të saj, z. P. K., në shtetin grek nga fillimi i viti 1994 deri në vitin 2010 kur janë kthyer në Shqipëri. Nga ky dokumentacion rezulton se z. P. K., ka qenë ti punësuar në Greqi dhe ka paguar sigurimet shoqërore rregullisht, si dhe rezulton se ka pasur të ardhura të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, në shumën totale rreth 171.712 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) euro. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur vërtetimet e punës dhe të pagës për motrën e bashkëshortes dhe bashkëshortin e saj për të provuar të ardhurat e tyre në Shqipëri përpara se znj. E. K., të blinte automjetin tip “Volvo x60” në qershor 2014, të cilin një vit e gjysmë më pas ia ka shitur bashkëshortes subjektit.

Nga këto vërtetime provohet se znj. E. K., me bashkëshortin kanë pasur të ardhura neto në shumën totale 2.568.179 (dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, më tepër se dyfishi i vlerës së automjetit të blerë prej saj, vetëm nga të ardhurat nga puna në Shqipëri në 2-3 tre vjetët e fundit para se ta blinte këtë autoveturë.

63. Për sa i përket përdorimit të këtij automjeti nga bashkëshortja e subjektit para se ta blinte, subjekti ka shpjeguar se ka qenë vetëm për shkaqe objektive të shkaktuara nga gjendja shëndetësore shumë e rëndë e motrës së bashkëshortes në këtë periudhë dhe se bashkëshortja e subjektit e ka asistuar sipas nevojave të saj. Subjekti ka paraqitur si prove dhe dokumentacionin e spitalit përkatës.

64. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se znj. E. K., dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Komisioni arsyeton se nuk mund të kryejë një analizë të plotë financiare për këta shtetas por në një vlerësim të përgjithshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve për blerjen e automjetit ato konsiderohen të mjaftueshme (referohuni tabelës më lart, pika 59).

65. Lidhur me pyetjen e Komisionit se – çfarë marrëdhënie pune ka me znj. E. K., – subjekti ka deklaruar se – znj. E. K., ka filluar punë si sekretare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në fillim të vitit 2011, periudhe në të cilën subjekti nuk ka qenë titullar i kësaj gjykatë. E., punonte si sekretare në seksionin familjar të gjykatës, ndërsa subjekti ka qenë gjyqtar në një tjetër seksion, në atë civil dhe deklaroi se nuk e ka asistuar kurrë si sekretare në asnjë çështje që ka gjykuar. Në gusht të vitit 2012 subjekti është komanduar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë përkohësisht deri në emërimin e kryetarit të kësaj gjykatë si kryetar i komanduar i

³³ Analiza financiare për vitet 2005 – 2016, i bashkëlidhet këtij materiali.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë në janar të vitit 2013 subjekti është emëruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë si Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë kësaj periudhe për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 109 i vitit 2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha kompetencat për rekrutimin dhe largimin e punonjësve të administratës gjyqësore i kaluan kancelarit dhe ministrit të Drejtësisë. Pra, autoriteti përgjegjës për marrëdhënien e punës për znj. E. K., sipas këtij ligji konsiderohej ministri i Drejtësisë dhe kancelari i gjykatës i emëruar nga ministri i Drejtësisë. Megjithatë shpjegon subjekti në kushtet kur iu besua detyra e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një mandat 4-vjeçar (në vitin 2013), subjekti, për shkak të ndërgjegjes etike dhe profesionale i ka kërkuar znj. E. K., që të japë dorëheqjen nga pozicioni i sekretares pranë gjykatës ku subjekti ishte kryetar, pikërisht, sepse ishte motra e bashkëshortes. Znj. E. K., është larguar nga kjo gjykatë pak kohë pas lejes vjetore të të njëjtit vit dhe Ministria e Drejtësisë e ka sistemuar në një punë tjetër në një gjykatë tjetër. Pra, nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie pune me znj. E. K.

Likuiditet e deklaruara nga bashkëshortja e subjekti i rivlerësimit

66. Gjendje *cash* në vlerë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë nga kursimet. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga paga si mjeke okuliste në Qendrën *** Tiranë.

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016 konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekësh nga kursimet.

67. Kursime, në vlerën 60.940,41 (gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet presje dyzet e një) lekë, në “Credins Bank”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga paga (shuma të pashpenzuara nga paga).

“Credins Bank”³⁴ konfirmon se bashkëshortja e subjektit zotëron llogarinë bankare (llogari page) me nr. ***, e cila në datën 12.1.2017 ka pasur gjendje vlerën 60.940 (gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

68. Konstatohet se deklarimi i personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Detyrime financiare

69. Detyrimi për kontratën e kredisë bankare të datës 24.3.2016 në “Credins Bank” e cila mbulohet nga paga e bashkëshortes së subjektit, znj. M. I. Subjekti ka deklaruar gjendjen e detyrimit në vlerën 10.209.699 (dhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje³⁵ konfirmohet se vlera e mbetur e kredisë në fund të vitit 2016 ka qenë 10.209.698 (dhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

70. Kontratë *overdrafti* – kartë krediti, datë 14.11.2016, me vlerë 200.000 (dyqind mijë) lekë, në “Credins Bank”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se subjekti ka lidhur kontratë *overdrafti* të lidhur me kartë krediti, në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, me qëllim blerjen e shërbimeve dhe të mirave materiale brenda dhe jashtë vendit.

71. Kartë krediti “BKT Prima”, datë 31.8.2016, në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në BKT.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, ka pasur kartë krediti “BKT Prima”, me limit në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të aktivizuar në datën 31.8.2016, e cila është përdorur për pagesën e tarifave të kopshtit të djalit të subjektit kundrejt fondacionit “****”.

³⁴Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2019, nga “Credins Bank” dhe vërtetimi i datës 23.1.2017 paraqitur nga subjekti (dosja ILDKPKI, ref. aneks 4/10).

72. Kontratë *overdrafti*, kartë krediti, datë 3.11.2016, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, në “Credins Bank”, e bashkëshortes së subjektit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se bashkëshortja e subjektit ka lidhur një kontratë *overdrafti*, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, me qëllim blerjen e shërbimeve dhe të mirave materiale brenda dhe jashtë vendit.

73. Konstatohet se deklaratimet janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

Vendbanimet e deklaruara nga subjekti

74. Apartament me sip. 100 m², k. ***, ap. ***, në kompleksin “****”, Tiranë, në vitet 2010 – 2017.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se banon në apartamentin me sip. 100 m², i ndodhur në Rr. “****”, kompleksi “****”, k. ***, ap. ***, Tiranë, marrë me qira 15.000 lekë/muaj, babait të tij. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale³⁶ të datës 27.9.2016, të zotit B. I., i cili posedon pasurinë e llojit apartament me sip. 100 m², të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, dhe se këtë pasuri ia jep me qira subjektit të rivlerësimit për një afat 5-vjeçar me çmim qiraje mujore 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013 subjekti nuk deklaroi adresë banimi, ndërsa në deklaratat periodike vjetore për vitet 2014, 2015 dhe 2016 subjekti deklaroi si adresë banimi: Rr. “****”, kompleksi “****”, k. ***, ap. ***, Tiranë.

75. Në përgjigje të pyetësorëve subjekti shpjegon se nga fillimi i vitit 2011 deri në nëntor të vitit 2017, ka jetuar me qira në adresën: Rr. “****”, kompleksi “****”, k. ***, ap. ***. Ky apartament ka qenë i porositur dhe i mobiluar nga babai i tij, z. B. I. Gjithashtu, subjekti deklaroi se vlera e qerasë së paguar për këtë apartament ka qenë 15.000 lekë/muaj dhe u është bërë me para në dorë prindërve të tij.

Për shkak të marrëdhënies së posaçme të besimit me qiradhënësin, për periudhën janar 2011 – shtator 2016 subjekti shpjegon se nuk ka kontratë të shkruar për qiranë.

76. Referuar kontratës³⁷ së porosisë për investim dhe dorëzim apartament banimi dhe vendparkimi të datës 23.9.2010 konstatohet se z. B. I., ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., apartament banimi me sipërfaqe 100 m² dhe garazh, në total për vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro – në objektin që kjo shoqëri po ndërtonte në Rr. “****”, Tiranë. Sipas kontratës vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro është paguar ditën e lidhjes së kontratës dhe kësti i dytë dhe i fundit prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro do të paguhej me regjistrimin në hipotekë të apartamentit.

77. Referuar dokumentit, “*procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive*” i mbajtur nga ILDKPKI³⁸ në datën 30.10.2014, lidhur me burimin e financimit për blerjen e apartamentit nga z. B. I., subjekti ka deklaruar se – *ky apartament nuk ka qenë i hipotekuar, ndërsa si burim të ardhurash për krijimin e këtij apartamenti deklaroi kontributin e dhënë nga vëllezërit e tjerë F., dhe F. I., dhe nga motra A. I.*

78. Nëpërmjet deklaratës noteriale³⁹ të datës 12.2.2019, z. B. I., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka shpjeguar se në godinën e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 13.10.2007, babai i tij ka porositur një apartament me sip. 90 m², me vlerë 56.700 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) euro – dhe në datën 23.9.2010 ka porositur apartamentin me sip. 100 m², kati 6 (kati shtatë me ashensor) dhe një vend parkimi, për vlerën në total prej 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro.

Si burim krijimi të këtyre pasurive ka deklaruar të ardhurat nga emigracioni i fëmijëve të tij, A., A., F., dhe F. I., si edhe të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar. Për apartamentin me

³⁶ Deklaratë noteriale nr. ***.

³⁷ Kontratë porosisë nr. ***.

³⁸ Dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2019.

³⁹ Deklaratë noteriale nr. ***.

sip.100 m² deklararon se ka paguar vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro në datën e porosisë dhe pjesën tjetër e ka paguar vitet e fundit.

79. Lidhur me këtë adresë banimi subjekti është pyetur edhe në ILDKPKI për burimin e të ardhurave të babait në krijimin e kësaj pasurie nga e cila ka rezultuar se është blerë me kontributin e fëmijëve të z. B. I., (pa përfshirë subjektin e deklaramit) dhe është përdorur vetëm nga subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj.

80. Nga hetimi rezultoi se babai i subjektit e ka blerë këtë apartament i cili është banuar që nga fillimi prej djali i tij, Fatri Islamaj. Subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë apartament duke pretenduar se ka pasur një marrëdhënie qiraje, por nuk rezultoi e deklaruar në asnjë rast, deri në datën 27.9.2016, ku lidhën një kontratë me afat 5-vjeçar, e cila në fakt ka përfunduar në nëntor të vitit 2017.

81. Mbështetur në faktet më sipër të cilat rezultuan gjatë hetimit administrativ lidhur me përdorimin e banesës nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se referuar pikës 14, të nenit 3, si edhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. B. I., (babai i subjektit), bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

82. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i kaloi barra e provës për të paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 100 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, porositur nga babai i subjektit në vitin 2010 dhe të përdorur nga subjekti për periudhën 2011 – 2017.

83. Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie me vlerë 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro ose [9.022.650 (nëntë milionë e njëzet e dy mijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekë⁴⁰], nga të cilat 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro [ose 6.940.500 (gjashtë milionë e nëntëqind e dyzet mijë e pesëqind) lekë] janë paguar në datën 23.9.2010, ndërsa pjesa e mbetur 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në vitet pasuese, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegon: – *Për sa i përket burimit të të ardhurave që i kanë shërbyer babait të subjektit për të porositur me kontratë sipërmarrje këtë apartament në vitin 2010, janë shpjeguar hollësisht në deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 12.2.2019 (f. 1-2) të babait B. I., si dhe në deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 12.2.2019, të shtetasit F. I., (si dhe provat shoqëruese të kësaj deklarate), të depozituara në Komision.*

84. Si dokumentacion provues që lidhet me këto shpjegime të dhëna nga babai i subjektit, z. B. I., për burimet financiare për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin, si vijon:

84.1 Të ardhura të z. F. I., nga aktiviteti tregtar në Zvicër (pa specifikuar shumën), në periudhën para vitit 2010, si person fizik i regjistruar dhe si ortak dhe administrator i shoqërisë tregtare “*****”, Zyrih. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin vijues:

- kopje të pasaportës italiane të z. F. I., të lëshuar në datën 12.11.2018;
- ekstrakt të shkarkuar nga faqja e internetit të shoqërisë tregtare “*****” sh.p.k., themeluar më 29.12.2004 (në gjuhë të huaj, pa datë dhe jo në formën e kërkuar nga ligji), ku rezulton se z. F. I., është bashkortak i kësaj shoqërie;
- dokument në gjuhë të huaj (jo në formën e kërkuar nga ligji), sipas të cilit rezulton se ky shtetas ka përfituar të ardhura në shumën 249.874 (dyqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) franga në Zvicër, për periudhën 2002 – 2007.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se provat e depozituara nuk janë në formën e kërkuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi, si dhe nuk evidentohen në mënyrë të qartë të ardhurat *neto* të përfituara dhe as tatimet e paguara mbi këto të ardhura nga z. F. I., në Zvicër.

⁴⁰ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

84.2 Të ardhura të z. F. I., nga shoqëria “****”, subjekti ka paraqitur kopje të dokumentacionit, si vijon:

- vendim i regjistrimit nr. ***, datë 15.2.2006, të shoqërisë “****”, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me ortak të vetëm z. F. I., me adresë: Rr. “****”, p. ***, me kapital themeltar 5.000.000 (pesë milionë) lekë, me objekt ruajtjen dhe sigurimin e objekteve dhe personave;
- kontratë shitjeje nr. *** rep., datë 25.7.2006, të 49 % të kuotave të kësaj shoqërie, ku shitësi F. I., (i cili jeton edhe sot në një familje me të atin, B. I.), ka përfituar vlerën prej 2.450.000 (dy milionë e katërqind e pesëdhjetë) lekësh;
- kontratë shitjeje nr. *** rep., datë 16.4.2007, të 51 % të kuotave të kësaj shoqërie, ku shitësi F. I., (i cili jeton edhe sot në një familje me të atin, B. I.) ka përfituar vlerën prej 64.000 (gjashtëdhjetë e katër mijë) euro.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se z. F. I., e ka themeluar këtë shoqëri me kapital themeltar 5.000.000 (pesë milionë) lekë në vitin 2006 dhe i ka shitur të gjitha kuotat e zotëruara brenda vitit 2007, në shumë totale 10.188.240 (dhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë, por nuk dokumentohet pagesa e çmimit të shitjes së kuotave dhe as pagesa e tatimit mbi diferencën e çmimit.

84.3 Të ardhura të z. F. I., (pa specifikuar shumën) nga bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k., me seli në Prishtinë, Kosovë, si agjent i kësaj shoqërie në Shqipëri në periudhën 2010 – 2012. Subjekti ka paraqitur me *e-mail*-in e datës 30.1.2019, dokumentacionin, si vijon:

- kopje të një autorizimi përfaqësimi të kësaj shoqërie, të datës 10.1.2011;
- konfirmim për marrëdhënie shërbimi nga kjo shoqëri, të datës 1.2.2019, ku konfirmohet puna e z. F. I., si agjent tregtar i shoqërisë në Shqipëri;
- kopje të disa kontratave të shitblerjes së kësaj shoqërie me shoqëritë “****” dhe “****” sh.a., të periudhës 2011 – 2012.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nuk vërtetohen të ardhurat e përfituara nga ky bashkëpunim dhe as pagesa e tatimeve përkatëse.

84.4 Të ardhura nga punësimi të z. A. I., në shoqërinë “****” sh.a., deri në vitin 2010. Subjekti ka paraqitur vërtetim nga ISSh-ja ku saktësohet paga neto e përfituar nga kjo kompani në periudhën 2000 – 2009, në shumën 11.440.787 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

Subjekti ka deklaruar se: *“Duhet të mbahet parasysh që kam qenë i shkëputur nga trangu familjar që në tetor 2007, kur jam martuar, ndërsa 3 vëllezërit e tjerë kanë vazhduar të qëndrojnë me prindërit edhe për shumë vite dhe aktualisht jetojnë së bashku me ta të dy vëllezërit e mi F., dhe F. I.*

*Sqaroj Komisionin se arsyeja përse po paraqes një vërtetim të ri të pagesës së vëllait A. I., si provë është, pasi konstatoj se të ardhurat që ai ka marrë pranë shoqërisë ‘***’ sh.a. (ish- ‘****’ sh.a.), janë shumë më të larta se ato që reflektonin vërtetimet e Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore të paraqitura nga ana ime në datën 20.11.2019. Ky ndryshim mendoj që vjen për shkak se është paguar edhe me honorare dhe shpërblime të larta, të cilat nuk janë reflektuar në regjistrat e DRSSh-së, ku pasqyrohet paga bazë. Nga ky vërtetim i datës 22.11.2019 rezulton që vëllai i madh, z. A. I., është paguar me një pagë neto 15.821.961 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë për vitet 2000 – 2010 dhe jetonte në një familje me prindërit. Ndërkohë, për tre vitet në vazhdim 2011 deri 2013 vetëm nga kjo shoqëri ka pasur rreth 11.310.507 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e dhjetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë neto të ardhura.*

Sqaroj se në mbledhjen e këtyre shumave kam zbritur tatimin i cili përshkruhet për secilin vit në vërtetim, dhe kjo është vetëm paga neto. Pra, vetëm paga e A. I., është më shumë se dyfishi i vlerës së apartamentit që im atë ka blerë në vitin 2010, pa llogaritur të ardhurat pas viti 2010”.

Përveç provave të depozituara deri në datën 20.11.2019, subjekti ka paraqitur edhe një vërtetim nr. *** prot., datë 22.11.2019, nga kjo shoqëri, ku përcaktohet paga bruto dhe tatimi i mbajtur mbi pagën për të vëllanë, për periudhën 2000 – 2013, por nuk evidentohet shuma neto e përfutur prej tij çdo vit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, provohet se të ardhurat neto nga paga e z. A.I., për periudhën 2000 – 2009, kanë qenë në vlerën 11.440.787 lekë (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë).

84.5 Të ardhura nga emigracioni të znj. A. I., bashkë me të shoqin, z. Q. C., në Londër, Angli, pa specifikuar shumën. Subjekti ka paraqitur⁴¹ kopje të dokumentacionit vijues (jo në formën e kërkuar nga ligji), si vijon:

- kopje të pasaportës angleze lëshuar në datën 27.1.2017; dokument në gjuhën angleze të lëshuar nga “****” i datës 24.8.2001 me të cilin ka përfutur statusin e azilantes në Angli; certifikatë martese në gjuhën angleze, sipas së cilës motra e subjektit është martuar me z. Q. H. (C.) në datën 25.4.2002;
- kopje në gjuhën angleze të ekstraktit të llogarisë bankare në bankën HSBC, për periudhën dhjetor 2018 - nga ku rezulton se përfiton pagën mujore 2.404 (dy mijë e katërqind e katër) GBP/muaj në kompaninë *** Ltd.

Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat e ligjshme motrës në periudhën përpara vitit 2010.

84.6 Të ardhura nga punësimi i z. F. I., pranë AKSHI, nga data 1.2.2008 e në vijim, pa specifikuar shumën. Subjekti ka paraqitur⁴², kopje të dokumentacionit vijues (jo në formën e kërkuar nga ligji):

- kopje të vërtetimit nr. *** prot., datë 18.4.2012, nga AKSHI, sipas të cilit z. F. I., rezulton i punësuar pranë këtij institucioni si specialist dhe përfiton pagën mujore neto 74.670 (shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë;
- kopje të librezës së punës sipas së cilës z. F. I., ka punuar pranë AKSHI-t në periudhën 1.2.2008 – 6.1.2014;
- kopje në gjuhën angleze të një vërtetimi nga *** University, sipas të cilit ka ndjekur në periudhën 2006 – 2007 një Master për IT dhe e ka përfunduar atë në datën 26.09.2007.

Subjekti ka deklaruar se: *“F., ka jetuar për rreth 4 vjet në Londër, Angli, ku ka studiuar dhe punuar, në periudhën 2003 – 2007. Gjatë kësaj periudhe ka pasur kursime në “Intesa Sanpaolo Bank” në llogari të përbashkët me të atin B., të cituara më poshtë”.*

Subjekti ka provuar marrëdhënien e punësimit të të vëllait F. I., pranë AKSHI-t në periudhën 2008 – 2014, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me shumën totale të të ardhurave të përfutur prej tij dhe as të pagesës së tatimeve mbi këto të ardhura.

84.7 Të ardhura nga pensionet e pleqërisë të prindërve të subjektit B., dhe M. I., në vlerën 2.361.665 (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në periudhën 1997 – 2009, për të cilat subjekti ka paraqitur vërtetimet përkatëse nga ISSH-ja.

84.8 Kursime ndër vite në “Intesa Sanpaolo Bank”, në periudhën deri në fund të vitit 2010, kur është porositur apartamenti.

Subjekti ka deklaruar se: *“Në këtë bankë, babai im B. I., ka pasur llogari të përbashkët me të birin F. I., i (cili ka jetuar dhe në Angli për rreth 4 vjet), me nr. llogarie ***, nga e cila rezulton se ka pasur depozitime dhe tërheqje në vlerën 17.859 (shtatëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) GBP në vitet 2004 – 2006, e cila sipas kursit të këmbimit të kohës është afërsisht në vlerën 3.196.761 (tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë. Gjithashtu, rezulton se në këtë bankë në llogarinë me nr. *** B., dhe F. I., kanë*

⁴¹ Me e-mail-in e datës 30.1.2019

⁴² Me e-mail-in e datës 30.1.2019

pasur kursime në vlerën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro të tërhequra deri në fund të vitit 2010. Këto prova janë pjesë e dosjes nga përgjigjet e bankave drejtuar Komisionit”.

Nga dokumentacioni bankar i administruar evidentohet, si më poshtë vijon:

- llogaria nr. *** është çelur në datën 14.4.2004 dhe në të janë kryer derdhje dhe tërheqje *cash* në vlera të ndryshme nga z. B. I., deri në datën 31.12.2011 nga kjo llogari janë tërhequr në total 5.555 (pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) GBP – ose 921.686 (nëntëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa llogaritur shumën 2.270 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) GBP transferuar te llogaria e subjektit në vitin 2005);
- llogaria nr. *** është çelur në datën 9.3.2009 dhe në të janë kryer derdhje dhe tërheqje *cash* në vlera të ndryshme nga z. B. I., deri në datën 31.12.2011 nga kjo llogari është tërhequr në total vlera prej 11.800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro.

85. Subjekti ka paraqitur në parashtrimet e tij deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.12.2019, ku A., A., F., dhe F. I., konfirmojnë se kanë mbështetur financiarisht babanë e tyre, z. B. I., për të blerë apartamentin me sip.100 m², kati 7 dhe një vend parkimi në kompleksin “****”, Rr. “****”.

Subjekti ka paraqitur certifikatën familjare të lëshuar në datën 13.11.2019 nga Njësia Bashkiake Nr. *** Tiranë, sipas të cilës në datën 15.11. 2008 në trungun familjar të babait të tij kanë qenë vëllezërit e tij A., F., dhe F. I., si dhe motra A. I.

86. Në shpjegimet e tij lidhur me mbajtjen e apartamentit të babait në adresën: Rr. “****”, kompleksi “****”, ap. ***, në Tiranë, subjekti paraqiti deklaratën noteriale me nr. ***, datë 26.5.2019, të z. B. I., i cili ka pohuar faktin përpara noterit se që prej muajit janar 2011 deri në vjeshtën e vitit 2017, z. Fatri Islamaj, ka qëndruar me qira në apartamentin e tij.

87. Në vlerësim të rezultateve të hetimit, të shpjegimeve dhe të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, Komisioni arriti në konkluzionin se:

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se e ka përdorur këtë apartament me kundërshtëpërbllim duke paraqitur si provë: deklaratë noteriale të babait të tij gjatë periudhës së rivlerësimit (me nr. *** rep., datë 12.2.2019); shpjegimet/deklarimet e tij lidhur me përdorimin e kësaj banese kundrejt qirasë; shpjegime lidhur me mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje qiraje në ILDKPKI, duke arsyetuar se nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për ta deklaruar këtë marrëdhënie dhe as formularët përkatës të deklarimit nuk kanë pasur ndonjë rubrikë për të deklaruar shpenzimet me vlerë nën 300.000 (treqind mijë) lekë.

Shpjegimet e subjektit nuk e bindën Komisionin se realisht mes tij dhe babait ka pasur një marrëdhënie qiraje, verbale e cila mbështetej në mirëkuptim deri në vitin 2016, po ashtu deklarata e babait nuk mund të konsiderohet si provë e fortë referuar kohës kur është deklaruar, si dhe marrëdhënies së posaçme mes tyre. Po ashtu, fakti se palët kanë vendosur të lidhin një kontratë në vitin 2016, e cila korrespondon me periudhën e miratimit të ligjit të vettingut, nuk e bindi Komisionin se ishte një marrëdhënie kontraktore në vazhdimësi, duhet të theksohet edhe fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka siguruar ndonjë dokumentacion (mandatarkëtim, transfertë bankare ose pagesa të taksave), për të provuar qiranë ndaj babait. Po ashtu, afati i kontratës së lidhur në vitin 2016 ishte 5-vjeçar, por u zbatua për më pak se një vit, dhe për pasojë Komisioni krijon bindjen se është lidhur pikërisht për të justifikuar marrëdhënien pararendëse të parregulluar dhe provuar si një marrëdhënie korrekte qiramarrjeje.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit se ky apartament u porosit dhe u ble nga babai i subjektit me të ardhurat e fëmijëve të tij dhe u përdor vetëm nga subjekti i rivlerësimit, nuk e bindi Komisionin se kjo ishte një marrëdhënie qiraje për të cilën subjekti duhej të përgjigjej vetëm mbi shpenzimet e kryera, të cilat gjithashtu ishin modeste.

Në vijim të këtij arsyetimi pretendimi i subjektit të rivlerësimit se babai i tij nuk duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, pasi sipas tij nuk gjendet në një raport interesi me të apo në kushtet e nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet i pabazuar në vlerësim të Komisionit. Për shkak se konsiderohet i provuar gjatë hetimit administrativ, fakti i përdorimit

të apartamentit për një periudhë të gjatë kohore, 6 vjet, në mënyrë konstante dhe të qëndrueshme, Komisioni çmon se kjo marrëdhënie duhet të konsiderohet të paktën si një marrëdhënie huapërdorjeje, sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, e cila përfshihet te marrëdhënia e huas që parashikon neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, marrëdhënie e cila e kategorizon babanë e subjektit, në këtë rast si person tjetër të lidhur, për këtë pasuri dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

Nga të dhënat e mbledhura lidhur me këtë pasuri është konstatuar se ky apartament është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit dhe është përdorur vetëm prej subjektit të rivlerësimit për një periudhë të gjatë kohore dhe pavarësisht këtij fakti subjekti nuk e ka deklaruar ndër vite deri në datën 27.9.2016, e cila korrespondon me ligjin e vettingut.

Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI shtohet/ndryshohet në deklarimet e tij të fundit, duke paraqitur si burim edhe të ardhurat e vëllait të subjektit, z. A. I., nga pagat që ka marrë pranë shoqërisë “****” sh.a.

Ky fakt i ri i paraqitur nuk duket bindës për Komisionin, pasi nga hetimi ka rezultuar se z. A.I., ka blerë deri në vitin 2010 pasuri në emër të tij duke përdorur pjesërisht të ardhurat e tij dhe pjesërisht kredi bankare.

Të ardhurat e deklaruara të vëllezërve dhe të motrës mund të tregojnë potencialisht mundësinë e tyre për të pasur të ardhura, por nuk rezultoi e provuar se kanë paguar tatime për të ardhurat, gjithashtu, nuk u provua në ndonjë mënyrë bindëse se ia kanë dhënë të ardhurat babait të tyre.

Gjithashtu, Komisionit nuk iu duk bindës fakti se ata mund të kenë financuar në blerjen e një apartamenti në emër të babit të tyre, i cili as nuk është përdorur prej tij dhe as ata si financues nuk kanë pretenduar bashkëpronësinë.

88. Në përfundim, duke analizuar konkluzionet e mësipërme në raport me njëra-tjetrën, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ishte në thelb duke përdorur një apartament (para dhe pas deklaratës “Vetting”), për të cilin subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit.

89. Në deklarimin periodik vjetor subjekti ka deklaruar si adresë banimi: Rr. “****”, kompleksi “****”, kulla ***, k. ***, ap ***, për periudhën 2005 – 2011.

Lidhur me këtë adresë, subjekti shpjegon se nga fundi i vitit 2005 deri në fund të vitit 2010 ka jetuar në adresën: Rr. “****”, kompleksi “****”, kulla ***, k. ***, ap ***, ku jetonte e vetme bashkëshortja e subjektit, znj. M. I. (L.), pasi prindërit e saj ishin larguar në SHBA.

Në periudhën 2005 – 2007 ka bashkëjetuar me znj. M. L. (I). Nga viti 2007 e në vazhdim subjekti ka bërë celebrimin dhe është martuar me znj. M. L. (I). Nga viti 2008 e në vazhdim subjekti i ka paguar qira prindërve të bashkëshortes në vlerën 10.000 lekë/muaj. Kjo marrëdhënie nuk ka qenë e formalizuar me shkrim dhe me pagesat merrej bashkëshortja e subjektit.

90. Subjekti ka depozituar në Komision deklaratën noteriale⁴³, datë 26.5.2019, me anë të së cilës z. D. L., ndër të tjera deklaron se – *në vitin 2001 ka blerë një apartament⁴⁴ në Rr. “****”, kompleksi “****”, kulla ***, k. *** – dhe se ka jetuar aty deri në vitin 2004 kur është shpërngulur me bashkëshorten në SHBA. Kur ata janë larguar apartamentin ia ka lënë vajzës së tyre M., e cila ka bashkëjetuar me Fatri Islamaj dhe nga viti 2008 kanë paguar qira mujore në vlerën 10.000 lekë/muaj deri sa janë larguar në vitin 2011, vit në të cilin këtë apartament ia kanë dhuruar djalit të tij, z. A. L., i cili vazhdon të jetoj aty.*

Referuar deklaratës noteriale⁴⁵ të datës 15.8.2011, këtë pasuri dhe të drejtat reale mbi të, shtetasit D., dhe F. L., ia dhurojnë djalit të tyre, z. A. L.

⁴³ Deklaratë noteriale nr. ***.

⁴⁴ Sipas deklaratës ky apartament është blerë me ndihmën e tre fëmijëve që ishin në emigracion.

⁴⁵ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.8.2011.

91. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e sipërmarrjes së datës 5.5.2001, sipas së cilës z. D. L., ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit apartamentin me sip. 85 m², në Rr. “****” nr. ***, k. ***, kulla ***, Tiranë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁴⁶, dërgon listën emërore të pronarëve të apartamenteve dhe njësisive të kompleksit “****”, kulla ***, Rr. “****”, Tiranë, nga ku rezulton se z. A. L., është pronar i një apartamenti në katin e nëntë me sip. 84.2 m² me nr. pasurie ***.

92. Në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se – “... ky apartament ka qenë i porositur nga i ati i bashkëshortes së tij, z. D. L., që në datën 5.5.2001. Subjekti sqaron se në kohën kur është porositur dhe paguar plotësisht ky apartament nga z. D. L., nuk e ka njohur këtë person dhe asnjë familjar të tij. Në këtë periudhë, jo vetëm që nuk ka qenë i martuar me vajzën e tij, por as nuk e ka njohur fare atë.”

Për sa i përket pyetjes së Komisionit lidhur me burimin e blerjes së këtij apartamenti – subjekti ka deklaruar se: “...i është thënë nga familjarët e bashkëshortes, se z. D. L., është mbështetur financiarisht për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001 nga tre fëmijët e tij në emigracion L., A., dhe E., por kryesisht nga i biri A. L.”

93. Për sa i përket pyetjes nëse është deklaruar apo jo marrëdhënia e qiramarrjes që ka pasur për këtë apartament, subjekti ndër të tjera sqaron se – “... si përdorues dhe bashkëqiramarrës i këtij apartamenti, nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për të deklaruar këtë kontratë para autoriteteve publike, por sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.2008. “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është detyrim i qiradhënësit, pra, subjektit që realizon të ardhura nga dhënia me qira, që të paguajë tatimin mbi këto të ardhura.”

94. Nga shqyrtimi i provave të paraqitura dhe nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se kjo pasuri është blerë para se subjekti të njihej me bashkëshorten e tij, si dhe para se të ishte në funksionin e gjyqtarit. Bashkëshortja e subjektit jetonte në shtëpinë e prindërve të saj dhe se ka vazhduar të jetojë po aty edhe pasi prindërit janë larguar në SHBA, në vijimësi të natyrshme të mënyrës se si bashkëshortja jetonte edhe më parë. Në vijim prindërit e saj ia kanë dhuruar këtë apartament djalit të tyre, z. A. L., i cili ka qenë edhe një nga kontribuuesit kryesorë në krijimin e kësaj pasurie. Mbështetur në këto fakte, Komisioni krijon bindjen se kjo është një pasuri e cila nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe është krijuar në mënyrë të pavarur nga subjekti.

95. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi si adresë banimi: Rr. “****”, pallati “****”, k. ***, ap. ***.

Vërehet se në deklaratën noteriale të datës 24.9.2018 të qiradhënësit, z. F. I., dhe të subjektit si qiramarrës, objekt i qirasë është apartamenti nr. ***.

Lidhur me këtë adresë banimi, subjekti ka shpjeguar se⁴⁷ – që nga nëntori i vitit 2017 dhe në vazhdim jeton me qira në adresën: Rr. “****”, pallati “****”, k. ***, ap. ***. Ky apartament i është marrë me qira subjektit ndërtues “****” sh.p.k. Më pas vëllai i subjektit, z. F. I., pasi i ka blerë apartamentin subjektit ndërtues “****” sh.p.k. ka vazhduar marrëdhënien e qirasë me pronarin e ri me të njëjtat kushte.

Subjekti ka sqaruar se ka pasur gjithmonë me qira ap. *** dhe se ap. *** është një lapsus apo gabim në deklarim, duke dhënë shpjegimet përkatëse, dhe se nuk ka dokumentacion për këtë apartament.

96. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë nga vëllai i subjektit (ap. ***), subjekti ka shpjeguar se është përfutur nëpërmjet blerjes me transfertën bankare të datës 25.8.2017, e cila ndodhet bashkëngjitur kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, e cila është në dispozicion të Komisionit.

⁴⁶ Shkresa nr.*** prot., datë 20.6.2019.

⁴⁷ Me përgjigjet e pyetësorit, datë 23.5.2019.

97. Nga verifikimi që Komisioni kreu në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, ka rezultuar se pasuria, apartament nr. ***, i përket shtetasve të tjerë, të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit, apo familjarëve të tij.

98. Lidhur me këtë apartament banimi, Komisioni konstaton se dokumentet e paraqitura përputhen me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk konstaton problematika për këtë pasuri.

Gjetje/çështje të tjera

99. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vitin 2005), subjekti deklaroi autoveturën tip “Cadillac Eldorado”, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë. Ndërsa, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti po në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk konfirmon që në emër të subjektit të ketë qenë i regjistruar automjeti i tipit “Cadillac Eldorado”.

100. Subjekti është pyetur lidhur me këtë pasuri, pasi edhe nga ILDKPKI-ja referuar dokumentit, “procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”⁴⁸ i datës 30.10.2014, subjekti ka deklaruar se – *nuk disponon kontratat e shitblerjes së këtij mjete, pasi këto transaksione janë kryer para shumë vitesh dhe se ky automjet ka qenë me targa të huaja. Gjithashtu, ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti kanë shërbyer si burim krijimi për depozitën e çelur prej tij në qershor të vitit 2007, në “Raiffeisen Bank”.*

Referuar dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”⁴⁹ konfirmohet se në datën 12.6.2007 subjekti ka depozituar në këtë bankë në depozitën me nr. ***, vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

101. Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë: (i) kur dhe kujt ia ka blerë këtë automjet; (ii) cili është burimi i krijimit të tij; dhe (iii) kur dhe kujt i`a ka shitur këtë automjet. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë çdo dokumentacion që disponon për këtë automjet dhe marrëdhënien juridike të shitblerjes së tij.

102. Subjekti ka deklaruar⁵⁰ se – *autoveturën tip “Cadillac Eldorado” me targa *** e ka blerë në fillim të shkurtit 2006 nga shtetasi A. E., banues prej shumë kohësh në Zvicër (i njohur i vëllait të subjektit, z. F. I., i cili banonte gjithashtu në Zvicër në atë kohë). Duke qenë se subjekti ka pasur vështirësi ta regjistrojë këtë automjet tek autoritetet përkatëse, për shkak të mungesës së disa pjesëve të këmbimit dhe vështirësive për t`i gjetur ato në Shqipëri, ka rënë dakord që t`ia kthejë automjetin shitësit dhe të marrë mbrapsht vlerën e paguar për blerjen e tij.*

103. Subjekti ka paraqitur si dokumentacion mbështetës për deklaratimet e tij: (i) foto të mjetit; (ii) kopje të librezës së regjistrimit të automjetit në Zvicër; (iii) e-mail-e të dërguara me qëllim gjetjen e pjesëve të këmbimit; (iv) deklaratë noteriale të z. A. E.

Në vijim subjekti ka shpjeguar se ky automjet edhe pse është blerë në vitin 2006 është përfshirë në deklarinimin fillestar në ILDKPKI, për të qenë transparent mbi pasuritë e zotëruara deri në momentin e deklarimit fillestar. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) kursimet nga të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës që nga tetori 2003; (ii) honoraret e përfituara si anëtar i bordit drejtues të kësaj shkolle; (iii) paga si gjyqtar nga fillimi i tetorit 2005 deri në fillim të shkurtit 2006; dhe (iv) të ardhurat nga mësimdhënia. Një pjesë e pagesës është kryer me kursimet *cash* dhe pjesa tjetër me kursimet në monedhën GBP tek “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 2.270 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) GBP (trajtuar më poshtë).

104. Nga hetimi⁵¹ ka rezultuar se subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij me nr. *** në “Intesa Sanpaolo Bank”, vlerën prej 1.782 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) GBP [ose 318.925 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë⁵²], në datën 6.2.2006. Gjithashtu,

⁴⁸ Përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2019.

⁴⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 7.1.2019.

⁵⁰ Përgjigje nr. 11, pyetësori datë 7.10.2019.

⁵¹ Referohuni transaksioneve në llogarinë e subjektit tek llogaria nr. *** pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në monedhën paund.

⁵² Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 6.2.2006

subjekti ka kryer tërheqje *cash* nga llogaria e tij e pagës në “Raiffeisen Bank”, deri në datën 7.2.2006, vlerën totale 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

105. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar lidhur me mundësitë e tij financiare për të blerë automjetin tip “Cadillac Eldorado”, në vlerën prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh, e cila rezulton me një diferencë negative prej 191.075 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

106. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vlera totale e automjetit është shlyer pjesërisht nga kursimet prej të ardhurave të realizuara në vitet 2003, 2004 dhe 2005 nga burimet e deklaruara në deklaratën “Vetting”, dhe pjesërisht me tërheqje bankare të konstatuara edhe nga Komisioni përgjatë vitit 2006.

107. Subjekti ka shpjeguar se deklarimi i parë fillestar është bërë nga subjekti në mars të vitit 2006 dhe nuk mund të diskutohet për deklarim kursimesh *cash* deri në datën e dorëzimit të kësaj deklarate në mars të vitit 2006. Në deklarimin fillestar ai ka deklaruar edhe automjetin e blerë në shkurt të vitit 2006, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, me burim kryesisht kursime të periudhës deri në datën 31.12.2005 në bankë ose jashtë saj.

Në kushtet kur deri në datën e blerjes së automjetit nuk kishte akoma deklarim fillestar para fillimit të detyrës, atëherë nuk ka asnjë argument juridik që të përjashtojë nga mundësia për të blerë këtë automjet me kursimet *cash* që subjekti ka pasur mundësi të kursejë deri në atë moment, nga të gjitha burimet e ligjshme të deklaruara për periudhën para fillimit të detyrës.

Subjekti ka deklaruar gjithashtu se të ardhurat e kësaj periudhe janë kursyer pothuajse të gjitha dhe nuk janë shpenzuar, pasi subjekti ka qenë beqar dhe jetonte me prindërit.

Një pjesë e këtyre kursimeve është derdhur në llogarinë e tij bankare nga babai, z. B. I., në vlerën 2.270 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) GBP, nga e cila subjekti ka tërhequr *cash* vlerën 1.782 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) GBP [ose 318.925 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë]. Një pjesë tjetër, vlerën prej 2.650 (dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro [ose 327.823 (treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë], subjekti e ka transferuar në datën 10.10.2005 tek i vëllai, z. F. I., i cili jetonte në Zvicër (konfirmohet nga “Raiffeisen Bank”), i cili ia ka kthyer në momentin e blerjes së automjetit, rreth datës 10.2.2006.

108. Nga verifikimi në ILDKPKI⁵³ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë vetëm një deklarim periodik në vitin 2006 (duke përthithur deklaratën para fillimit të detyrës dhe atë periodike vjetore).

109. Komisioni, bazuar në informacionin e administruar në lidhje me datën e dorëzimit të deklaratës para fillimit të detyrës në mars të vitit 2006, ka rikryer analizën financiare të kësaj pasurie, duke pranuar shpjegimet e subjektit për kursimet jashtë sistemit bankar deri në shkurt 2006, si vijon:

Analizë për blerjen e automjetit “Cadillac Colorado” në shkurt 2006	Vlera në lekë
Total pasuri	693.046
Cadillac Colorado	600.000
Likuiditete <i>cash</i> deri më 28.2.2006	93.046
Të ardhura deri më 31.12.2005	1.196.581
Shpenzime jetike për 1 person për periudhën 2003 – 2005	297.485
Rezultati financiar (të ardhura - shpenzime - pasuri)	206.050

Subjekti justifikon me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

110. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa ***, në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, por nuk ka deklaruar

⁵³ Shkresa nr. *** prot., datë 13.11.2019, nga ILDKPKI-ja.

burimin e krijimit të kësaj pasurie. Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2013, subjekti ka deklaruar se e ka shitur këtë automjet kundrejt vlerës 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor⁵⁴ ka dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 28.1.2013 ia ka shitur⁵⁵ këtë automjet vëllait të tij, z. F. I., në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, por, nuk disponohet informacion dhe dokumentacion në lidhje me transaksionin e blerjes së këtij mjeti nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007. Referuar dokumentit “procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”⁵⁶ mbajtur në datën 30.10.2014, në ILDKPKI – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk disponon kontratën e blerjes së këtij mjeti.

111. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 7.10.2019, subjekti ka deklaruar⁵⁷ se – e ka blerë këtë automjet në verën e vitit 2007 në Zvicër, ku ka shkuar me avion dhe është kthyer me këtë automjet. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rezulton se subjekti ka udhëtuar jashtë vendit në datën 23.7.2007 me kompaninë ajrore “***” dhe është kthyer në datën 28.7.2007 me traget nga ***, Itali.

Subjekti ka paraqitur kopje të përkthyer nga gjuha gjermane (e cila mban vulën e doganës shqiptare), të deklaratës së shitjes së automjetit tip “Mercedes Benz 202”, lëshuar në datën 20.7.2007, në Zyrih, Zvicër, nga z. F. I., tek blerësi Fatri Islamaj, në vlerën 2.850 (dymijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro [ose 348.242 (treqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e dy) lekë⁵⁸].

112. Në vijim subjekti sqaron se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, pasi ka përfshirë edhe shpenzimet e zhdoganimit të paguar për këtë automjet.

Si burim i blerjes së këtij automjeti subjekti deklaron: një pjesë të shumës së përfituar nga shitja e automjetit “Cadillac” në vitin 2006, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë; kursime të bashkëshortes nga puna në shoqërinë “***” sh.p.k.; dhe kursime *cash* nga pagat e subjektit të rivlerësimit.

113. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar në ILDKPKI⁵⁹ se ka çelur një depozitë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007 me burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Cadillac” në vitin 2006, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka depozituar në datën 12.6.2007, vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë në depozitën nr. ***, në “Raiffeisen Bank”, shumë e cila nuk është tërhequr nga subjekti deri në janar 2008.

114. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe në vetëdeklarimet e subjektit, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe me shpenzimet, për periudhën 1.1.2007 – 20.7.2007 (data kur është blerë automjeti), pasqyruar në tabelën, si më poshtë:

Analizë e blerjes së automjetit “Mercedes Benz” në datën 20.7.2007	Vlera në lekë
Të ardhura F. Islamaj si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, datë 1.1.2007 – 20.7.2007	444.826
Të ardhura M. I., si mjeke në “***” sh.p.k.	176.028
TOTAL të ardhura	620.854
Shpenzime jetike për dy persona sipas ILDKPKI-së (6 muaj)	136.620
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS deri më 23.7.2007	110.028
TOTAL shpenzime	246.648
Blerje automjet tip “Mercedes Benz” më 20.7.2007	700.000
Diferencë në likuiditete	1.235.184
TOTAL pasuri	1 935 184
REZULTAT FINANCIAR	-1.560.978

⁵⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 16.1.2019.

⁵⁵ Kontrata nr. ***, datë 28.1.2013.

⁵⁶ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2019, në Komision.

⁵⁷ Përgjigjia nr. 12, pyetësori i datës 7.10.2019.

⁵⁸ Përlogarit me kursin zyrtar të këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në këtë datë (1 euro = 122,19 lekë).

⁵⁹ Procesverbali “mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 30.10.2014, pika 8.

115. Në këtë analizë financiare, përfshihet edhe shtesa e likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortes), përfshirë këtu edhe depozitën me vlerë 500.000 (pesëqind mijë) lekë, krijuar më 12.6.2007, në “Raiffeisen Bank”, trajtuar edhe më sipër. Pra, balanca negative e fondeve përfshin edhe vlerën e kësaj depozite.

116. Analiza financiare nuk përfshin gjendjen e llogarisë bankare nr. *** në monedhën euro të bashkëshortes së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” (për të cilën subjekti ka deklaruar se nuk ka qenë e bashkëshortes, por e familjarëve). Kjo llogari do të trajtohet në vijim të këtij materiali.

117. Subjektit i kaloi barra e provës për të shpjeguar lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të disponueshme për blerjen e automjetit.

118. Subjekti ka shpjeguar se vlera totale të blerjes së autoveturës është paguar e shtrirë në kohë dhe jo në mënyrë të menjëhershme. Shpenzimet për këtë automjet përfshijnë vlerën e blerjes së autoveturës prej 2.850 (dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, si dhe vlerën e shpenzimeve të doganës dhe transportit. Fillimisht subjekti ka bërë një pagesë me transfertë bankare në vlerën 754 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër) euro në datën 15.6.2017, duke ia transferuar nga llogaria në euro te “Raiffeisen Bank”, në llogari të vëllait të subjektit, z. F. I., siç rezulton edhe nga ekstrakti i bankës. Subjekti pasi është kthyer në Shqipëri ka bërë pagesën e doganës për këtë automjet, dhe më vonë ka paguar pjesën tjetër të çmimit të blerjes prej 2.100 (dymijë e njëqind) euro [ose 262.500 (dy mijë e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë], duke ia dhënë të vëllait⁶⁰, pas mesit të muajit tetor kur ka qenë në Tiranë.

119. Në lidhje me burimin e kësaj pasurie, subjekti deklaron se e ka blerë këtë automjet me:

- të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Cadillac” në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë në vitin 2006 (të cilat i ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2006);
- kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga të ardhurat nga punësimi në vitin 2006 dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2007;
- tërheqjet e kryera nga llogaritë bankare të bashkëshortes deri në muajin tetor 2010 (duke përfshirë kthimin e shumës 3.900 (tre mijë e nëntëqind) euro dhënë hua xhaxhait të saj, E.L, në vitin 2007).

120. Subjekti ka kërkuar që analiza financiare të përfshijë kursimet e tij dhe të bashkëjetueses nga viti 2006, edhe pse nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, për shkak të konfuzionit me faktin se kishte bërë deklarinimin e të ardhurave dhe burimin e tyre, si dhe nuk ishte e konsoliduar plotësisht mënyra e deklarimit nga subjektet deklaruese. Gjithashtu, subjekti shton se nuk ka pasur detyrim ligjor të deklaronte kursimet e bashkëjetueses dhe se e kishte të pamundur të ndante kursimet e tij *cash* nga ato të bashkëshortes në fund të vitit 2006.

Në lidhje me kursimet e bashkëjetueses gjatë vitit 2006, subjekti deklaron se ajo ka kursyer një shumë të përafërt me të ardhurat nga pagat e këtij viti, të tërhequra nga llogaritë bankare të pagës gjatë vitit 2006.

Subjekti ka kërkuar edhe rillogariten e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit në këtë periudhë, duke paraqitur dokumentacion justifikues⁶¹ për disa udhëtime pune.

121. Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, vendosi të rillogaritë analizën financiare të kësaj pasurie deri në datën 20.7.2007 (pasi subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues për pagesën e doganës në tetor të vitit 2010), duke përfshirë kursimet e mundshme të bashkëjetueses në fund të vitit 2006 në vlerën prej 661.536 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të tërhequra prej saj nga llogaria e pagës dhe vlerën prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh, të përfituar nga shitja e automjetit “Cadillac” (të sipërtrajtuar), si dhe duke rillogaritur shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit.

⁶⁰ Mënyra e pagesës së çmimit provohet me deklaratën noteriele të z. F. I.

⁶¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 19.11.2019, nga Shkolla e Magjistraturës.

122. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe i bashkëjetueses së tij, gjendja e likuiditeteve deri në këtë periudhë, dhe për këtë arsye nuk është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit për të përfshirë në këtë analizë tërheqjet nga llogaritë bankare të bashkëjetueses së tij gjatë vitit 2007. Gjithashtu, theksohet se subjekti nuk e ka përmendur më parë faktin se një nga burimet e përdorura për blerjen e këtij automjeti ka qenë kthimi i huas së marrë nga xhaxhai i bashkëjetueses, z. E. L., në vitin 2007 në “Raiffeisen Bank”.

Kjo analizë paraqitet në tabelën, si më poshtë vijon:

Analizë e blerjes së automjetit “Mercedes Benz” në datën 20.7.2007	Vlera në lekë
Të ardhura F. Islamaj si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, 1.1.2007 – 20.7.2007	444.826
Të ardhura M. I., si mjeke pranë “***” sh.p.k.	176.028
TOTAL të ardhura	620.854
Shpenzime jetike për dy persona sipas ILDKPKI-së (6 muaj)	136.620
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i> deri më 23.7.2007	22.368
TOTAL shpenzime	158.988
Blerje automjet “Mercedes Benz” më 20.7.2007	700.000
Diferencë në likuiditete	-26.494
TOTAL pasuri	673.506
REZULTAT FINANCIAR	-211.640

Në përfundim rezultoi se subjekti nuk e justifikon me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti në diferencën negative prej 211.640 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh.

Subjekti tregtar i regjistruar në emër të personit të lidhur, znj. M. I.

123. QKB-ja⁶² informon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. I., figuron e regjistruar si person fizik NIPT ***. Gjithashtu, për këtë person fizik rezulton licencë – kabineti mjekësor për okulistikë, lëshuar nga QKB-ja me nr. *** me status “aktiv”. Sipas kësaj licence dhe ekstraktit historik të regjistrimit në QKB, vendi i kryerjes së veprimtarisë është Njësia Administrative Nr. ***, Rr. “****”, nr. ***, Tiranë.

Bazuar në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar rezulton se znj. M. I., është regjistruar si person fizik në datën 12.9.2017 (pas deklaratës “Vetting”), me emrin tregtar “****”, me fushë veprimtarie, “*tregtimi i syzeve optike, si dhe aksesori të tjerë optike, ofrimi i shërbimeve të konsulencës mjekësore në fushën e okulistikës, vlerësimi i shëndetit të syrit dhe ekzaminimet përkatëse.*”

124. Sipas shpjegimeve të subjektit⁶³ bashkëshortja e ushtron aktivitetin në ambient me qira me sip. 59 m². Kjo pasuri është në pronësi të vëllait të subjektit. Gjithashtu, konstatohet se subjekti “M. I.,” person fizik, ka marrë me qira pajisjet mjekësore nga shoqëria “****” sh.p.k.

125. Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2017 të dorëzuar në ILDKPKI, personi i lidhur ka deklaruar qarkullim të kryer nga aktiviteti i saj tregtar në vlerën 1.488.012 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dymbëdhjetë) lekë dhe fitimin në vlerën 383.012 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e dymbëdhjetë) lekë.

126. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁶⁴ informon se të ardhurat e realizuara nga personi fizik në vitin 2017 janë në vlerën 1.488.012 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dymbëdhjetë) lekë, shpenzimet në vlerën 1.105.000 (një milion e njëqind e pesë mijë) lekë ndërsa fitimi 383.012 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e dymbëdhjetë) lekë.

127. Deklarimi i personit të lidhur përputhet me informacionin dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Konstatime në lidhje me deklaratimet/mosdeklarimet e likuiditeteve bankare, ndër vite, të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij.

⁶² Shkresa me nr. ***, datë 9.1.2019.

⁶³ Shihni përgjigjet e pyetësorit, datë 30.1.2019. Subjekti bashkëlidh kontratën e qirasë, datë 3.1.2018, sipas së cilës z. F. I., i jep me qira znj. M. I., njësinë e shërbimit me sip. 35 m² si dhe 24 m² nga një njësi me sip. 124 m², në total sip. prej 59 m² me qira mujore prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh. Gjithashtu, subjekti bashkëlidh kontratën e qirasë për pajisjet mjekësore të dhëna me qira nga subjekti “****” sh.p.k., në vlerën 25.000 lekë/muaj plus 5.000 lekë TVSH.

⁶⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 28.1.2019.

128. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 depozitë në emër të tij në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 501.750 (pesëqind e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë dhe pakësimet e saj në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008 dhe 2009.
129. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar rezulton se subjekti ka çelur në “Raiffeisen Bank” në datën 12.6.2007 një depozitë me nr. ***, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, të derdhur *cash*⁶⁵. Nga kjo depozitë janë tërhequr shuma të ndryshme *cash* deri në shkurt 2010, dhe nga ky moment nuk është përdorur më nga subjekti. Kjo depozitë është mbyllur përfundimisht në datën 24.1.2017.
130. Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI⁶⁶ se burimi i krijimit të kësaj depozite janë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Cadillac” në vitin 2006, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, shumë e cila është depozituar në bankë në vitin 2007. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se *nuk i ka deklaruar pakësimet e depozitës pasi ajo është lehtësisht e verifikueshme edhe sepse nuk ka pasur detyrim të deklarojë shpenzimet me vlerë më të vogël se 500.000 (pesëqind mijë) lekë.*
131. Sikurse është evidentuar më sipër konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion justifikues ligjor shitjen e automjetit tip “Cadillac” në vitin 2006 – si rrjedhim edhe të ardhurat e përfituara prej tij. Për më tepër, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti nuk ka deklaruar si shtesë pasurie vlerën prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh gjendje *cash*, të përfituar nga shitja e automjetit.
132. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
133. Subjekti ka shpjeguar se shuma e depozituar në “Raiffeisen Bank” është shpenzuar plotësisht në vitet 2008 dhe 2009 dhe nuk është përdorur për të investuar në asnjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në të ardhmen, pra, nuk ka ekzistuar në momentin e deklaratës “Vetting”.
134. Subjekti sqaron se kur është çelur kjo depozitë është deklaruar dhe burimi i të ardhurave të tyre në formularin përkatës edhe në mandatar-këtimin e bankës ku ka pasqyruar faktin që kjo shumë rrjedh nga shitja e automjetit. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti i është drejtuar “Raiffeisen Bank” me një kërkesë që të më sigurojë një kopje të dokumentacionit përkatës të kësaj depozite. Por me shkresën nr. ***, datë 2.12.2019, “Raiffeisen Bank” i ka bërë me dije subjektit se është e pamundur të sigurohet ky dokumentacion, pasi për shkak të kalimit të afatit 10 vjeçar që parashikon rregullorja për arkivin pranë kësaj banke është bërë asgjësimi i këtij dokumentacioni. Ai shton se, referuar nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” provohet pamundësia për ta provuar me dokument bankar burimin e kësaj depozite, por ky fakt provohet plotësisht me pohimet e shpjegimet gjatë këtij procesi, të cilat konsiderohen prova në kuptim të nenit 214 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe procesverbali i deklarimit në ILDKPKI në tetor 2014.
135. Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, krijoi bindjen se mungesa e deklarimit ka qenë nga pakujdesia dhe vendosi të përfshijë në likuiditetet *cash* të vitit 2006 vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë të përfituar nga shitja e automjetit tip “Cadillac” (trajtuar gjerësisht më sipër), dhe për pasojë subjekti e justifikon me burime të ligjshme krijimin e kësaj depozite.
136. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 gjendjen e llogarisë në vlerën 3.477 (tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) euro, në “Credins Bank”.

⁶⁵ Shumë e derdhur në datën 12.6.2007 në llogarinë rrjedhëse të subjektit në “Raiffeisen Bank”, e cila në të njëjtën datë kalon në depozitë.

⁶⁶ Procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, datë 30.10.2014, pika 8.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar rezulton se subjekti ka çelur një llogari rrjedhëse me numër *** në monedhën euro në “Credins Bank” në datën 29.12.2009 dhe në këtë llogari ka përfituar pagesat për mësimdhënie nga Universiteti *** i Tiranës.

Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI⁶⁷ se burimi i kësaj llogarie kanë qenë të ardhurat nga mësimdhënia dhe se nuk e ka deklaruar gjendjen e llogarisë meqenëse ka deklaruar burimin e krijimit të saj te seksioni i të ardhurave në deklaratat periodike vjetore

137. Në përfundim Komisioni konstaton se nuk është deklaruar kjo llogari në deklaratat periodike vjetore në periudhën 2009 – 2013, por janë deklaruar rregullisht të ardhurat e përfituara, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj llogarie.

Provohet se burimi i krijimit të kësaj llogarie bankare janë të ardhurat nga mësimdhënia pranë Universiteti *** i Tiranës dhe në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë llogari, si dhe gjendjen e saj në momentin e deklarimit.

138. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, nuk është deklaruar gjendja e llogarisë së personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, në vlerën 432.778 (katërqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, në “Credins Bank”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar rezulton se në datën 16.1.2013 bashkëshortja e subjektit ka çelur llogarinë rrjedhëse me nr. *** në monedhën lekë, në “Credins Bank” dhe në këtë llogari ka përfituar të ardhurat nga paga si mjeke nga Qendra *** Tiranë nga viti 2013 e në vijim.

Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI⁶⁸ se burimi krijimi i kësaj llogarie kanë qenë të ardhurat e bashkëshortes nga pagat dhe se nuk e ka deklaruar gjendjen e llogarisë meqenëse ka deklaruar burimin e krijimit të saj te seksioni i të ardhurave në deklaratat periodike vjetore.

139. Në përfundim Komisioni konstaton se personi i lidhur nuk e ka deklaruar gjendjen e kësaj llogarie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, por janë deklaruar të ardhurat nga paga në Qendrën *** Tiranë.

Provohet se burimi i krijimit të kësaj llogarie bankare nga të ardhurat nga paga në Qendrën *** Tiranë dhe në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë llogari dhe gjendjen e saj në momentin e deklarimit.

140. Transaksione të kryera në llogaritë bankare, ndër vite, të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortes së tij. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes janë konstatuar disa transaksione, si vijon:

141. Transferimi i vlerës 2.270 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) GBP, në datën 13.12.2005, nga z. B. I., (babai i subjektit), në llogarinë rrjedhëse nr. *** në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të subjektit.

Subjekti ka deklaruar⁶⁹ se kjo shumë është transferuar nga llogaria e babait të tij, z. B. I., në datën 13.12.2005 dhe se në deklaratën dorëzuar në ILDKPKI në mars 2006 e ka deklaruar këtë shumë, por të konvertuar në lekë.

Nga informacioni i administruar⁷⁰ konfirmohet se vlera 2.270 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) GBP është transferuar nga llogaria bankare nr. **, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 13.12.2005, në emër të B., dhe F. I., te llogaria e subjektit.

Në lidhje me burimin e kësaj shume, subjekti deklaroi se janë kursimet nga pagat e tij, në periudhën që ka jetuar me prindërit, të cilat ia ka dhënë babait për t'i konvertuar në monedhën paund, i cili i ka kthyer nëpërmjet kësaj transferte.

⁶⁷ Procesverballi mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, datë 30.10.2014, pika 9.

⁶⁸ Procesverballi mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, datë 30.10.2014, pika 9.

⁶⁹ Përgjigjja nr. 4, pyetësori datë 7.10.2019.

⁷⁰ Nr. *** prot., datë 9.01.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Kjo shumë është përdorur në shkurt 2006 për blerjen e automjetit tip “Cadillac Eldorado” (trajtuar më sipër).

Nga analiza financiare e kryer⁷¹, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi ta kursejë këtë shumë me burime të ligjshme.

142. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 depozitë bankare në vlerën 458.000 (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa specifikuar të dhënat e llogarisë dhe burimin e krijimit të saj.

Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI⁷² se kjo llogari është krijuar nga bashkëshortja para martesës, me mbiemrin e vajzërisë L., dhe pas martesës ato janë pakësuar.

BKT-ja⁷³ nuk konfirmon gjendje llogarie depozitë, në vlerën prej 458.000 (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, në datën 31.12.2007.

I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë depozitë subjekti ka deklaruar⁷⁴ se – *bashkëshortja e tij ka deklaruar gabimisht gjendjen e llogarisë së saj të pagës në BKT me nr. ***, nga puna pranë shoqërisë “***” sh.p.k., në fund të muajit mars 2008 dhe jo gjendjen më 31.12.2007, siç parashikohet nga ligji.*

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues – kopje të ekstraktit të kësaj llogarie në BKT (administruar edhe nga Komisioni), e cila konfirmon se bashkëshortja e subjektit ka përfutur në këtë llogari pagën e saj dhe se gjendja në datën 27.3.2008 ka qenë në vlerën 458.210 (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dhjetë) lekë.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioni, rezulton se kemi të bëjmë me llogari rrjedhëse dhe jo llogari depozitë. Konfirmohet gjendja e kësaj llogarie në datën 27.3.2008, në vlerën 458.210 (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dhjetë) lekë.

143. Në llogarinë bankare nr. ***, në monedhën euro, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të personit të lidhur, ndër të tjera janë konstatuar këto transaksione:

- i) në datën 30.11.2005, derdhje *cash* nga znj. M. I., vlera 3.900 (tre mijë e nëntëqind) euro;
- ii) në datën 24.1.2006, derdhje *cash* nga z. P. K., vlera 10.000 (dhjetë mijë) euro;
- iii) në datën 24.1.2006, transfertë në hyrje pa përshkrim, vlera 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro;
- iv) në datën 26.1.2006, tërhequr *cash* nga znj. M. I., vlera 20.000 (njëzet mijë) euro;
- v) në datën 18.5.2007, derdhje *cash* nga znj. M. I., vlera 5.480 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro;
- vi) në datën 10.8.2007, derdhje *cash* nga znj. M.I., vlera 4.000 (katër mijë) euro;
- vii) në datën 11.1.2008, tërheqje *cash* nga znj. M. I., vlera 8.600 (tetë mijë e gjashtëqind) euro;
- viii) në datën 14.9.2009, derdhje *cash* nga znj. M. I., vlera 1.500 (një mijë e pesëqind) euro; dhe
- ix) në datën 19.11.2009, tërheqje *cash* nga znj. M. I., vlera 7.760 (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro.

Subjekti ka deklaruar⁷⁵ se – *kjo llogari është hapur nga bashkëshortja e tij në datën 30.11.2005 në periudhën kur prindërit e saj u larguan për të jetuar në Amerikë (rreth dy vjet para martesës).*

- Vlera 3.900 (tre mijë e nëntëqind) euro e depozituar në datën 31.11.2005 e ka burimin te kursimet e prindërve para se të largoheshin.
- Çdo shumë tjetër e depozituar nga bashkëshortja në këtë llogari, nuk ka qenë e saj por e vëllait A. L., e motrës E. K., dhe e bashkëshortit të saj, P. K., të cilët prej vitesh jetonin në Greqi.
- Vlera 10.000 (dhjetë mijë) euro e depozituar në datën 24.1.2006 nga z. P. K., e ka burimin nga kursimet e tij nga puna në Greqi, të cilat kanë qenë të depozituara në Bankën

⁷¹ Trajtuar në vijim të këtij materiali (analiza para fillimit të detyrës).

⁷² Procesverbali datë 30.10.2014, pika 6.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2019, nga BKT.

⁷⁴ Përgjigja nr. 7, pyetësori datë 7.10.2019.

⁷⁵ Përgjigja nr. 5, pyetësori datë 7.10.2019.

Ndërkombëtare Greke (NBG) në Athinë, në llogarinë nr. ***, në emër të tij dhe bashkëshortes së tij, znj. E. K. Kjo shumë është tërhequr në datën 24.1.2006 dhe është depozituar në të njëjtën ditë në Bankën Amerikane në Athinë, në llogarinë e znj. M. I.

- Vlera 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro është depozituar në datën 24.1.2006 nga z. A. L., me burim kursimet nga puna e tij dhe e bashkëshortes S. L., në Greqi, të depozituara në llogarinë e tyre në Bankën Amerikane në Greqi.

- Qëllimi i depozitimit të këtyre shumave të mësipërme ka qenë nevoja e xhaxhait të bashkëshortes, z. E. L., për të shlyer këstet e një apartamenti të blerë prej tij, duke i dhënë hua vlerën 20.000 (njëzet mijë) euro.

- Në vitin 2007 xhaxhai i bashkëshortes ka shlyer huan kundrejt z. P. K., duke i dhënë bashkëshortes së subjektit vlerat prej 5.480 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro në datën 18.5.2007 dhe 4.000 (katër mijë) euro në datën 10.8.2007, e cila i ka derdhur ato në llogari. Në janar të vitit 2008 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr vlerat 1.000 (një mijë) euro dhe 8.600 (tetë mijë e gjashtëqind) euro të cilat ia ka dhënë z. P. K.

- Në vitin 2008 xhaxhai i bashkëshortes ka shlyer huan kundrejt z. A. L., duke i dhënë bashkëshortes së subjektit vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, e cila e ka depozituar në llogari në datën 12.11.2008. Kjo shumë nuk është tërhequr nga z. A. L., deri në vitin 2010, madje i ka dhënë bashkëshortes së tij edhe 1.500 (një mijë e pesëqind) euro të tjera nga kursimet e tij për t'i depozituar në bankë në datën 14.9.2009. Në datën 19.11.2010, znj. M. I., ka tërhequr përfundimisht vlerën prej 7.760 (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro, duke ia kthyer të vëllait.

- Bashkëshortja e subjektit, për shkak të neglizhencës, e ka harruar të hapur këtë llogari dhe pse nuk ka kryer veprime me të dhe e ka mbyllur në datën 27.1.2017.

- Subjekti thekson se nuk ka pasur dijeni për këtë llogari dhe veprimet e kryera në të, duke qenë se shumtë e mësipërme nuk kanë qenë të bashkëshortes, por të familjarëve të saj. Vlerat monetare të qarkulluara në këtë llogari nuk kanë shërbyer si burim për asnjë nga pasuritë apo shpenzimet e kryera nga subjekti dhe bashkëshortja pas martesës.

144. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si vijon:

i) Deklaratë noteriale⁷⁶ të z. E. L., ku deklaron se ka marrë nga znj. M. I., hua vlerën 20.000 (njëzet mijë) euro në datën 26.1.2006, për arsye urgjente familjare, të cilën ia kanë dërguar nipi dhe mbesat e tij dhe se këtë shumë ia ka kthyer me këste, sipas mundësive ekonomike të tij dhe fëmijëve.

ii) Deklaratë noteriale⁷⁷ të z. A. L., ku deklaron se në datën 24.01.2006 ka transferuar vlerën 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro në llogarinë bankare të motrës së tij, znj. M. I., nga llogaria e tij dhe e bashkëshortes në Bankën Amerikane, dega Athinë, me burim punën e tyre në Greqi.

iii) Ekstrakt të transfertës bankare nga llogaria bankare nr. *** e A., dhe S. L., të datës 29.12.2006 në vlerën 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro, me përshkrimin “transfertë nga emigrantët”.

iv) Ekstrakt të transfertës bankare nga z. P. K., në datën 24.1.2006 të vlerës 10.000 (dhjetë mijë) euro në llogarinë bankare nr. *** në emër të znj. M. L.

145. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe më parë, në përgjigje të pyetësorit të datës 30.1.2019, kopje në gjuhën greke të dokumenteve të siguracionit të z. P. K., në periudhën mars 2002 – qershor 2010 dhe të asistencës së përfituar nga znj. E. K., në vitin 2005.

P. K., ka sqaruar në deklaratën noteriale⁷⁸ se burimi i të ardhurave të tij janë kursimet e familjes ndër vite në emigracion dhe deklaron se ka punuar për 18 vjet në Greqi që nga fillimi i vitit 199, duke qenë në marrëdhënie punë të pandërprerë në kompanitë më të mëdha në fushën e ndërtimit, por për periudhën 1998 – 2002 shteti grek i mbante siguracionet në formë manual, prandaj disponon dokumentacion vetëm për periudhën 2002 – 2010.

⁷⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.10.2019.

⁷⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.10.2019.

⁷⁸ Deklaratë noteriale nr. *** datë 12.2.2019.

146. Duke qenë se këto para janë në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, subjektit i kaloi barra e provës të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të qarkulluara në llogarinë bankare dhe se të ardhurat nuk janë të subjektit dhe të bashkëshortes, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor (në formën e kërkuar nga ligji), për prejardhjen e këtyre të ardhurave, burimin e krijimit dhe destinacionin final të tyre (sipas shpjegimeve të dhëna më parë nga subjekti i rivlerësimit).

147. Subjekti i ka qëndruar shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur në datën 15.10.2019 në Komision, duke deklaruar se transferimi i shumave nga shtetasit E. K., dhe A. L., është kryer para martesës (rreth 2 vjet), prandaj nuk mund të deklaronte asnjë veprim apo llogari të bashkëjetueses sipas ligjit në fuqi në atë kohë. Burimi i këtyre shumave janë kursimet nga puna shumëvjeçare në emigracion në Athinë, Greqi.

148. Në lidhje me derdhjen *cash* të vlerës prej 10.000 (dhjetë mijë) euro nga z. P. K., në datën 24.1.2006, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues⁷⁹ (me vulë apostile, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar), sipas të cilit rezulton se ka qenë i punësuar në kategorinë “vepra teknike dhe ndërtimore” në Greqi dhe gjatë periudhës 1996 – 2005 ka realizuar të ardhura në vlerën prej 77.414 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) euro. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion bankar sipas të cilit ka çelur depozitën bankare nr. *** në datën 8.12.2004, në të cilën janë depozituar vlera të ndryshme monetare dhe në datën 24.1.2006 është tërhequr vlera 10.000 (dhjetë mijë) euro dhe kopje të transfertës bankare nga “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas të cilës, z. P. K., ka depozituar *cash* vlerën prej 10.000 (dhjetë mijë) euro në datën 24.1.2006, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit.

149. Në lidhje me transfertën e vlerës prej 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro nga z. A. L., në datën 24.1.2006, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues⁸⁰ (me vulë apostile, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar), sipas të cilit rezulton se ka qenë i punësuar në kategorinë “vepra teknike dhe ndërtimore” në Greqi dhe gjatë periudhës 1999 – 2005 ka realizuar të ardhura në vlerën prej 31.571 (tridhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) euro. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion bankar sipas të cilit z. A. L., ka çelur depozitën nr. *** në datën 18.8.1997, në Bankën Kombëtare Greke, dhe në të janë depozituar shuma të ndryshme monetare dhe në datën 2.2.2006 ka pasur gjendje vlerën 17.552 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) euro, si dhe kopje të transfertës bankare të lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas të cilës shtetasit A., dhe S. L., kanë transferuar shumën 6.110 (gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) euro në datën 24.1.2006 me përshkrimin “transfertë nga emigrantët”, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit. Subjekti deklaroi se dega e kësaj banke në Greqi është mbyllur prej disa vitesh ndaj është e pamundur marrja e një vërtetimi, por dokumenti i lëshuar nga filiali në Tiranë mban kodin “100”, i cili ka qenë kodi i degës greke të kësaj banke në vitin 2006.

150. Në lidhje me blerjen e apartamentit nga huamarrësi E. L., (xhaxhai i bashkëshortes së subjektit), subjekti ka paraqitur dokumentacionin vijues:

- kontratë të thjeshtë sipërmarrje, datë 14.10.2003, me të cilën z. E. L., porositi apartamentin me sip. 98 m², në Rr. “****” nga shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 32.340 (tridhjetë e dy mijë e treqind e dyzet) euro [ose 4.322.241 (katër milionë e treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e dyzet e një) lekë], e cila do të paguhet me këste;
- kontratë të thjeshtë sipërmarrjeje, datë 20.5.2005, me të cilën z. E. L., porositi parkingun me sip. 43.2 m², në Rr. “****” nga shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 15.120 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) euro [ose 4.322.241 (katër milionë e treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e dyzet e një) lekë], e cila do të paguhet me këste;
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.12.2007, me të cilën z. E. L., blen apartamentin me sip. 98 m², në Rr. “****” nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 3.400.000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë, e cila është likuiduar para nënshkrimit të kontratës jashtë zyrës noteriale;

⁷⁹ Deklaratë përgjegjësie, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Greke dhe ekstrakt të llogarisë bankare pranë Bankës Kombëtare Greke.

⁸⁰ Deklaratë përgjegjësie, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Greke dhe ekstrakt të llogarisë bankare pranë Bankës Kombëtare Greke.

- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.12.2007, me atë së cilës z. E. L., dhe i biri G. L., blejnë bodrumin me sip. 43.2 m², në Rr. “***” nga shoqëria “***” sh.p.k., në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, e cila është likuiduar para nënshkrimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

151. Komisioni vlerësoi të pranohet dokumentacionin e paraqitur, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me transaksionet e kryera në këtë llogari dhe të mos e përfshijë gjendjen e saj në analizën financiare të kryer për periudhën 2006 – 2016.

152. Bashkëshortja e subjektit ka një llogari të përbashkët rrjedhëse me të vëllain e saj, z. A. L., me nr. ***, në monedhën lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank” e cila nuk është deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratat periodike vjetore.

Nga shqyrtimi i kësaj llogarie konstatohet se në këtë llogari janë kryer veprime në periudhën gusht 2006 – tetor 2015 dhe se është përdorur më së shumti nga shtetasi A. L.

153. I pyetur nga Komisioni në lidhje me kontributin e bashkëshortes së tij në këtë llogari, si dhe burimin e shumave të depozituara prej saj në këtë llogari, subjekti dha shpjegimet e tij,⁸¹ si vijon – *bashkëshortja e tij e ka hapur këtë llogari së bashku me të vëllanë, z. A. L., i cili në atë periudhë ishte emigrant në Greqi, me qëllim për t’i ardhur në ndihmë për veprime të ndryshme në Tiranë. Kjo llogari është përdorur më së shumti nga vëllai i saj, dhe veprimet e vetme të kryera nga bashkëshortja e tij, rezultojnë derdhjet e shumave monetare si vijon: (i) derdhje në vlerën 90.415 (nëntëdhjetë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekë në datën 14.8.2006; (ii) derdhje në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë në datën 20.11.2006; (iii) derdhje në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë në datën 10.07.2007; (iv) derdhje në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në datën 10.3.2008 – në një total vlera prej 160.145 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekësh.*

154. Në lidhje me burimin e këtyre vlerave subjekti deklaroi se ato janë kursime nga paga e bashkëshortes si mjeke në Qendrën Shëndetësore “***”, Tropojë, në vitin 2006 dhe paga si mjeke në shoqërinë “***” sh.p.k., në periudhën korrik 2006 – 2008.

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se totali i të ardhurave të znj. M. I., për periudhën 2006 – 2008 nga punëdhënësit e sipërcituar është në vlerën 1.910.070 (një milion e nëntëqind e dhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë.

155. Sipas vetëdeklarimit, shumat e depozituara në këtë llogari deri më 10.10.2007 (data e martësës me subjektin), si dhe derdhja e vlerës prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh i janë lënë z. A. L., si parapagesë për qiranë nga viti 2008 dhe në vazhdim.

156. Nga viti 2008 dhe në vazhdim kjo llogari është përdorur vetëm nga z. A. L., dhe burimi i shumave të derdhura nga në këtë llogari, janë të ardhurat nga emigracioni, gjithashtu, në këtë llogari është derdhur në mënyrë periodike pensioni i invaliditetit i të atit, z. D. L.

157. Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se kjo është një pasuri e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit e krijuar para martesë dhe e përdorur prej saj deri në vitin 2008.

Nisur nga fakti se kjo llogari ka qenë llogari dyemërore (në emër të bashkëshortes së subjektit dhe vëllait të saj), Komisioni vendosi të llogarisë në analizën financiare, si pasuri të bashkëshortes, gjysmën e gjendjes së saj në fund të çdo viti.

Analiza financiare për periudhën 2006 – 2016

158. Nga informacioni i administruar nga Komisioni⁸² rezultoi se subjekti (i cili ka filluar detyrën në tetor të vitit 2005) ka dorëzuar deklaratën para fillimit të detyrës në mars të vitit 2006, por nuk ka plotësuar datën e dorëzimit të saj. Gjithashtu, subjekti nuk ka dorëzuar deklaratën periodike vjetore të vitit 2005.

⁸¹ Përgjigjja nr. 6, pyetësori i datës 7.10.2019.

⁸² Shkresa nr. *** prot., datë 13.11.2019, nga ILDKPKI.

159. Nisur nga këto rrethana, Komisioni ka kryer analizën financiare duke e ndarë, si vijon: analizë financiare para fillimit të detyrës deri në shkurt të vitit 2006; dhe analizë financiare për periudhën mars 2006 – dhjetor 2016.

160. Analiza financiare për periudhën 2006 – 2016 përfshin të ardhurat, shpenzimet, likuiditetet dhe pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, znj. M. I. Pavarësisht se janë martuar në datën 10.10.2007⁸³, bashkëshortja e subjektit është përfshirë në analizën financiare, duke filluar nga viti 2006 bazuar në deklaratimet e subjektit se kanë filluar të bashkëjetojnë që në fund të dhjetorit të vitit 2005⁸⁴.

161. Në lidhje me likuiditetet, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vendosi:

- të përfshijë në gjendjen *cash* të vitit 2006 shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, të përfituar nga shitja e automjetit tip “Cadillac” gjatë këtij viti;
- të përfshijë në gjendjen *cash* të vitit 2006 vlerën totale të tërheqjeve *cash* nga llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit gjatë vitit 2006 [në vlerën 661.536 (gjashtëqind mijë e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë];
- të mos përfshijë gjendjen e llogarisë bankare me nr. *** në monedhën euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, të bashkëshortes së subjektit (të sipër trajtuar).

162. Në lidhje me shpenzimet e jetesës, subjekti ka kërkuar – *të zbriten shpenzimet për pushime sipas standardit të ILDKPKI-së për bashkëshorten, e cila provohet që ka kaluar pushimet jashtë dhe është llogaritur si shpenzim TIMS dhe nuk mund t’i mbivendosen shpenzimet për pushime jashtë shtetit me ato të llogaritura në shpenzimet standarde. Duhet verifikuar edhe blerjet me kartë krediti jashtë vendit me qëllim për të zbritur nga kjo shumë vlerat e karburantit, ushqim dhe veshmbathje nëse rezultojnë të mbivendosura.*

Në metodologjinë e përdorur nga Komisioni shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për llogariten në një zë më vete pa prekur shpenzimet minimale jetike sipas INSTAT. Gjithashtu, shpenzimeve të kryera nëpërmjet kartave të kreditit të subjektit dhe bashkëshortes në periudhën 2012 – 2016 i është zbritur 5 % e vlerës, sipas anketës së buxhetit të INSTAT-it, prandaj Komisioni vendosi të mos kryejë korrigjime të rubrikës së shpenzimeve në analizën financiare.

Gjithashtu, subjekti ka kërkuar t’i korrigjohen shpenzimet jetike, duke për llogaritur shpenzime për një person deri në fund të vitit 2005, pasi ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshorten në fillim të vitit 2006.

Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit duke e reflektuar në analizën financiare.

163. Në lidhje me të ardhurat, subjekti ka pretenduar se nuk i janë llogaritur në mënyrë të saktë të ardhurat nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes në vitin 2012, pasi sipas deklaratimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, shuma totale e të ardhurave të tyre rezultojnë 1.716.865 (një milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar mbi të ardhurat, rezultoi se shuma e të ardhurave për këtë vit ka qenë 1.633.067 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, vlerë e cila është për llogaritur në analizën financiare të vitit 2012.

Nuk janë kryer ndryshime të të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortes së tij në këtë vit.

164. Në përfundim, sipas analizës financiare të rishikuar nga Komisioni me elementët e mësipërm, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, justifikojnë me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe përballimin e shpenzimeve të kryera për periudhën 2005 – 2016, përveç një difference negative minimale prej 25.814 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë, në vitin 2012.

⁸³Referuar certifikatës së martesës nr. ***, datë 10.10.2007, lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. *** Tiranë (bashkëngjitur pyetësorit të datës 30.1.2019).

⁸⁴Përgjigjja nr. 5, pyetësori i datës 7.10.2019.

Subjekti i rivlerësimit FATRI ISLAMAJ	Deri ne 28 SHKURT 2006	1 Mars - 31 Dhjetor 2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	866 433	1 668 573	-137 746	-929 612	48 698	474 932	-560 611	538 143	372 225	-230 105	629 248	10 823 647	13 563 823
Autoveture Cadillac Eldorado	600 000												600 000
Autoveture MERCEDES BENZ targa xxxx			700 000										700 000
Apartament rruga "xxxx", sip.144 m2												10 548 500	10 548 500
Automjet TOYOTA CAMRY targa xxxx													0
Automjet VOLVO targa xxxx											800 000		800 000
													0
Shtesa/pakesime ne LIKUIDITET	266 433	1 668 573	-837 746	-929 612	48 698	474 932	-560 611	538 143	372 225	-230 105	-170 752	275 147	915 323
Gjendja e Likuiditetit ne fund te vitit	266 433	1 935 005	1 097 259	167 647	216 345	691 276	130 665	668 808	1 041 034	810 928	640 176	915 323	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10 209 698	10 209 698
Kredi bankare xxxx												10 209 698	10 209 698
													0
PASURI NETO	866 433	1 668 573	-137 746	-929 612	48 698	474 932	-560 611	538 143	372 225	-230 105	629 248	613 948	3 354 124
TE ARDHURA deklaruar													0
TE ARDHURA dokumentuar	1 434 663	1 985 118	1 421 584	1 394 696	1 318 929	1 711 490	1 566 177	1 633 067	2 315 252	1 931 784	2 272 830	2 258 180	21 243 770
Te ardhura nga paga Fatri Islamaj	319 540	696 371	816 024	839 963	878 472	830 418	852 862	894 705	1 038 342	1 251 388	1 252 691	1 258 269	10 929 045
Te ardhura nga honorare Fatri Islamaj	1 004 773	49 320	0	0	35 798	596 744	358 322	478 087	202 363	232 303	290 978	281 736	3 530 424
Te ardhura nga paga bashkeshortja M. Islamaj	110 350	639 427	605 560	554 733	404 659	284 328	354 993	260 275	474 547	447 779	728 109	718 175	5 582 935
Te ardhura nga shitja e automjetit CADILLAC		600 000											600 000
Te ardhura nga shitja e automjetit MERCEDES BENZ targa xxxx									600 000				600 000
Te ardhura nga interesat bankare depozita xxxx M. Islamaj										314	1 052		1 366
													0
NR. PERSONA	1 & 2	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3	3	
SHPENZIME	334 004	251 869	308 908	474 540	529 038	653 348	482 698	1 120 738	632 716	1 346 830	1 437 448	1 532 846	9 104 983
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-se	334 004	182 595	273 240	273 240	273 240	273 240	273 240	279 096	340 808	659 994	672 828	705 276	4 540 801
Shpenzime interesi per shlyerjen e kredise tek xxxx												233 794	233 794
Shpenzime udhetimi sipas sistemit TIMS		69 274	35 668	81 300	135 798	260 108	29 458	370 957	40 661	252 198	353 639	263 777	1 892 838
Shpenzime per kopshtin e te birit - xxxxx												150 000	150 000
Shpenzime blejje veshje e te tjera nga llogarite bankare dhe kartat e kreditit Fatri Islamaj dhe bashkeshortja								123 022	71 247	254 638	230 980	0	679 887
Shpenzime qiraje ap. Rr. "xxxx", komp. "xxxx".		0	0	120 000	120 000	120 000							360 000
Shpenzime qiraje ap. Rr. "xxxx", komp. "xxxx".		0	0	0	0	0	180 000	180 000	180 000	180 000	180 000	180 000	1 080 000
													0
Shpenzime mjekesore ne xxxxx bashkeshortja e subjektit viti 2012								167 664					167 664
													0
Analiza dokumentuar	234 226	64 676	1 250 422	1 849 768	741 193	583 211	1 644 090	-25 814	1 310 311	815 060	206 134	111 386	8 784 663

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm lidhur me pasuritë dhe të drejta të tjera reale që subjekti dhe personat e lidhur me të gëzojnë.

Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” (dorëzuar më 25.1.2017) një llogari bankare të përbashkët me vëllain e saj, për të cilën Komisioni ka hetuar disa depozita ndër vite, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.

Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi çmon se për apartamentin me sip. 100 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës “Vetting”), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

B. KONTROLI I FIGURËS

165. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport⁸⁵ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Fatri B. Islamaj.

Referuar këtij raporti, Grupi i Punës është informuar nëpërmjet DSIK-së se në datën 26.1.2017 subjektit të rivlerësimit, z. Fatri B. Islamaj, i është revokuar viza amerikane. Kjo rrethanë nuk është pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës, pasi subjekti Fatri Islamaj e ka plotësuar në datën 25.1.2017 (1 ditë para revokimit të vizës), arsye që tregon se subjekti nuk ishte në dijeni të faktit, por në kompleksitetin e vlerësimit të figurës së z. Fatri B. Islamaj ky fakt duhet të merret në konsideratë pasi:

166. Subjekti i rivlerësimit, pasi i janë kërkuar shpjegime nga Komisioni mbi revokimin e vizës amerikane, ndër të tjera, sqaron se⁸⁶ në fund të janarit të vitit 2017 është kontaktuar me telefon nga zyra konsullore e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë ku u ftua të paraqitej në Ambasadë, por, për shkak të një impenjimi familjar nuk mundi të shkonte. Rreth fundit të prillit të vitit 2017, tre muaj më vonë, subjektit iu dorëzuan një zarf që përmbante letrën e dërguar nga zyra konsullore e Ambasadës së SHBA-së, me anë të së cilës i ishte revokuar viza turistike për në SHBA, pasi sipas zyrës konsullore z. Fatri Islamaj nuk plotësonte kushtet për kategorinë e vizës turistike BI/B2, në zbatim të nenit 214/b, të ligjit për emigracionin që në kohën e lëshimit të saj (*Section *** of the United States Immigration and Nationality Act*).

Subjekti vazhdon shpjegimin e tij duke sqaruar se, pasi kishte studiuar rastet që gjen zbatim neni 214/b (*Section 214/b of the United States Immigration and Nationality Act*), konstatonte se me të vërtetë ka pasur një situatë familjare, e cila lidhet me rastet që sipas këtij neni viza turistike nuk mund të jepej.

167. Gjithashtu, subjekti sqaron se gjatë gjithë karrierës së tij ka pasur raporte shumë të mira me Ambasadën e SHBA-së në Tiranë dhe me projekte të Departamentit të Shtetit në Shqipëri

⁸⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 1.4.2019.

⁸⁶ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 30.1.2019.

në sektorin e drejtësisë. Para vizës për të cilën është njoftuar se është revokuar, ka pasur dhe tre viza të tjera të kategorive të ndryshme për në SHBA.

168. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit dhe kërkoi të dhëna të përditësuara nga institucionet ligjzbatuese, sipas parashikimeve të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Nga informacionet e ardhura nuk rezultuan të dhëna apo *indicie* që mund të ndikojnë në vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit: (i) deklaratën për kontrollin e figurës; (ii) raportin e DSIK-së; (iii) si dhe zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, barazisë së palëve në procesin gjyqësor, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të figurës, arrin në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

169. Subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në periudhën nëntor 2006 – prill 2010 ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier; në periudhën prill 2010 – gusht 2012 ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; në periudhën gusht 2012 – nëntor 2016 ka ushtruar detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; ndërsa që prej nëntorit të vitit 2016 dhe aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁸⁷

170. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Të dhëna nga burimet arkivore: Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Fatri Islamaj janë paraqitur gjithsej 7 ankesa (1 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

- 5 ankesa (1 e viti 2013, 2 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe një ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë.

⁸⁷ Raporti nr. *** prot., datë 9.4.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj”.

- 2 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:
 - 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtarit për efekt të vlerësimit profesional dhe etik.
 - 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje gjykimi, është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin Fatri Islamaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në përgjithësi identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Analizon normën në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj. Në një rast analiza ligjore e rrethanave të çështjes është konsideruar e gabuar nga Gjykata e Apelit, duke ndryshuar vendimin (shihni dosjen 2).

Z. Fatri Islamaj ka njohuri për procedurën e gjykimit, por nuk kujdeset për detajet. Kështu, në një rast është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit grafik, por nuk është kryer për shkak të mosparaqitjes së palës që e ka kërkuar (palës së paditur), për të mundësuar marrjen e dorëshkrimeve të lira dhe nuk është revokuar ky vendim (shihni dosjen 2).

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, përgjithësisht janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural dhe është e standardizuar.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin Fatri Islamaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

171. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional. Komisioni, në tërësi, vërejtë se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor në vendimmarrjet e tij, si dhe ruan normat etiko-profesionale.

Komisioni konstaton se, lidhur me njohuritë ligjore, subjekti ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Subjekti zotëron njohuri ligjore dhe të arsyetimit ligjor, referuar nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Ai ka aftësi organizative, referuar nenit 74/4/5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konstatohet se subjekti respekton etikën në punë dhe integritetin profesional. Subjekti ka pasur gatishmëri për t’u angazhuar dhe i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, sipas nenit 76/4/5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raste të mundshme të konfliktit të interesit/papajtueshmërisë

172. Gjatë vlerësimit profesional të subjektit, përveçse raportit të ardhur nga KLGJ-ja, Komisioni ka hetuar edhe lidhur me raste të mundshme të konfliktit të interesit /papajtueshmërisë, gjatë ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Fatri Islamaj.

1. Më konkretisht, nga vëzhguesi ndërkombëtar është përcjellë një vendim i Gjykatës së Lartë, lidhur me një çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, administroi nga Gjykata e Apelit Tiranë dosjen e plotë gjyqësore që lidhet me këtë rast.

Nga verifikimi i kësaj dosjeje konstatohet se kemi të bëjmë me një çështje gjyqësore me objekt “shfuqizimi ‘i vendimit për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve’, bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 20.1.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, me kërkues ILDKPKI-në.

Rezulton se, ILDKPKI-ja ka ankimuar në gjykatë vendimin, “për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve për subjektin A. D.,” ku me vendimin nr. ***, datë 14.2.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: pranimin e kërkesës ankimore, duke shfuqizuar vendimin për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 20.1.2017.

Në vijim të ankimit të bërë nga prokurori i çështjes, është investuar Gjykata e Apelit. Në përbërjen e trupit gjykues, që ka shqyrtuar këtë çështje, ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit. Me vendimin nr. ***, datë 6.3.2017, ky trup gjykues ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 14.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga ILDKPKI-ja, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 12.4.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 6.3.2017, të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, me arsyetimin se anëtari i trupit gjykues, z. Fatri Islamaj, ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë për ushtrimin e detyrës, për shkak të mosmarrëveshjeve që ka pasur vëllai i tij, F. I., (si Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë) me palën rekursuese ILDKPKI-në.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është konstatuar ndonjë kërkesë për dorëheqjen e gjyqtarit Fatri Islamaj nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

Nga verifikimi i vendimit të Gjykatës së Lartë është konstatuar se pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë ka sjellë prishjen e vendimit nr. ***, datë 6.3.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, për shkak të konfliktit në dukje të interesit të gjyqtarit Fatri Islamaj.

Për sa më sipër, se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në kushtet e konfliktit në dukje të interesit. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me këtë konstatim.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se trupi gjykues nuk ka vendosur për meritat e çështjes, pra, nuk ka shqyrtuar në themel kërkimet e kërkuesit ILDKPKI, por ka konstatuar problemet procedurale për sa i përket cenimit të parimit kushtetues dhe ligjor “të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj”, parim ky i garantuar edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 6 të saj dhe nga jurisprudenca e kësaj gjykate në një numër të madh çështjesh. Në këto kushte, bazuar në nenin 428/ç të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr. ***, datë 6.3.2017, ky trup gjykues ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 14.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

Subjekti ka sqaruar se pasi është njohur me aktet e dosjes konstaton se pala kërkuese në këtë çështje penale, që ishte një institucion shtetëror, ILDKPKI-ja, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ndër 5 faqe me pretendime të ndryshme, në faqen 5 ka parashtruar edhe pretendimet se z. Fatri Islamaj, si anëtar i trupit gjykues ka qenë në konflikt interesi dhe nuk duhet të merrte

pjesë në këtë trup gjykues për shkak të konfliktit që vëllai i tij i madh kishte me këtë institucion. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar pretendimet e kërkuarit ILDKPKI, duke dhënë vendimin e sipërcituar.

Fillimisht, subjekti sqaron se kjo praktikë e Gjykatës së Lartë është e para dhe e vetmja deri tani në të gjithë praktikën gjyqësore shqiptare për një rast të tillë. Si rrjedhim, subjekti nuk kishte asnjë referencë apo praktikë të mëparshme të Gjykatës së Lartë për të vlerësuar që pjesëmarrja e tij në një trup gjykues që shqyrton një kërkesë penale, për më tepër të karakterit urgjent, do të konsiderohej se ishte në papajtueshmëri me ligjin apo me parimet e konfliktit të interesit, vetëm për shkak se institucioni që ka bërë kërkesën drejtuar gjykatës ka nxjerrë në të kaluarën një akt administrativ për një të afërm të tij (të vëllain F. I.), fakt për të cilin ky institucion nuk e ka vënë në dijeni si anëtar të trupit gjykues.

Në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen të gjitha rastet e papajtueshmërisë, kur gjyqtari duhet të japë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, të cilat janë: *“1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: (a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private, ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij; (b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private, ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij, ose e bashkëshortit të tij; (c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; (ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërit prej palëve private; (d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar, ose dëmtuar nga vepra penale; (dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen, ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; (e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; (ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”*.

Subjekti, në përfundim, sqaron se është krejtësisht e qartë që nuk ka qenë në rrethanat e konfliktit në dukje të interesit në gjykimin e çështjes në fjalë. Referuar dhe standardeve më të mira ndërkombëtare si Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore apo të Jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (shihni Castillo Algar kundër Spanjës, (1998) 30 E.H.R.R. 827) rrethana e përmendur nuk mund të konsiderohet si papajtueshmëri apo konflikt interesi.

Vëzhguesi ndërkombëtar pyeti subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike nëse ai kishte dijeni, në kohën e gjyimit, se vëllai i tij kishte një konflikt me ILDKPKI-në (palën ndërgjyqëse), pyetje të cilës subjekti i rivlerësimit ju përgjigj se kishte pasur dijeni.

2. Komisioni ka hetuar mbi raste të tjera të mundshme të konfliktit të interesit.

Gjatë hetimit administrativ për komponentin e pasurisë, është konstatuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A. B. I., e ka blerë pasurinë e llojit apartament, me sip. 96 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, nga shoqëria “****” sh.p.k., kundrejt vlerës 45.340 (dyzet e pesë mijë e treqind e dyzet) euro. Ky transaksion është regjistruar në kartelën e pasurisë në datën 28.8.2014. Më tej, ky apartament i është dhuruar babait të subjektit të rivlerësimit, i cili e shkëmben me pasurinë e llojit tokë arë, me sip. 6.300 m² në ***, Durrës.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka gjykuar dy çështje, ku si palë ndërgjyqëse është shoqëria “****” sh.p.k.⁸⁸.

⁸⁸ (1) Çështja gjyqësore, me palë paditëse shtetasen E. K., palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt: “zgjidhje kontrate sipërmarrjeje dhe kthim detyrimi”, për të cilën Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 29.10.2018; (2) çështja gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k., palë të paditur shoqërinë “****” etj., me objekt: “Detyrimin solidar të paditurve të përmbushin detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e nënshpërmarrjes dhe bashkinvestimit të datës 16.4.2009, me nr. ***, dhe të aktmarrëveshjes datë 30.1.2010, me vlerën 100.000 (njëqind mijë) euro, etj.”, për të cilën Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 19.4.2017.

Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në kushtet e konfliktit në dukje të interesit. Komisioni i kërkoi shpjegime lidhur me këtë konstatim.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me dy rastet kur ka qenë në përbërjen e trupit gjykues, në njërin rast si anëtar dhe në tjetrin si kryesues, por nuk ka qenë në asnjë rrethanë të konfliktit në dukje të interesit për gjykimin e këtyre çështjeve, pasi nuk ka pasur asnjë informacion që shoqëria “****” sh.p.k., ka pasur një kontratë sipërmarrjeje dhe më pas shitblerjeje me njërin nga vëllezërit e tij, të nënshkruar që në vitin 2007.

Subjekti sqaron se – *“Lidhur me këto çështje, ku unë kam qenë anëtar i trupit gjykues sqaroj se nuk kisha asnjë djeni apo informacion se shoqëria ‘***’ ka pasur një marrëdhënie kontraktuale me njërin nga vëllezërit e mi A. I. Sqaroj se kam tre vëllezër dhe një motër të lindur para meje, dhe nuk kisha asnjë mundësi për të ditur se me kë kanë pasur marrëdhënie kontraktuale gjatë jetës së tyre. Ndërkohë, marrëdhënia kontraktuale e A., me këtë shoqëri ka qenë e një periudhe shume të hershme, pra, e vitit 2007, mbi dhjetë vite përpara se të gjykoja këto dy çështje. Vlen të mbahet parasysh fakti që A., është larguar nga ky apartament disa vite para se ta shiste (rreth vitit 2012), dhe banon në një apartament tjetër. Ky fakt e bën akoma më të pamundur për mua që të kisha informacion në vitin 2018 që apartamenti ku ka jetuar A., para se të transferohej në banesën aktuale ku është prej rreth 7 vitesh ishte ndërtuar nga ‘***’ sh.p.k.*

*Gjithashtu, mund të shtoj se në asnjërin prej dy çështjeve ku ka qenë palë shoqëria ‘***’ nuk rezulton që të jenë dhënë vendime në favor të kësaj shoqërie. Për më shumë, çdo argument dhe arsye e vendimmarrjes është e pasqyruar në vendimet përkatëse.”*

173. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për asnjërin prej tre çështjeve që është ngritur për diskutim ekzistenca e konfliktit të interesit, nuk rezulton të jetë kërkuar përjashtimi i gjyqtarit nga trupi gjykues, madje palët janë shprehur se janë dakord me përbërjen e trupit gjykues në momentin kur është bërë shpallja e tij në secilën prej këtyre çështjeve.

Lidhur me vendimin nr. ***, datë 6.3.2017 të Gjykataës së Apelit Tiranë, Komisioni çmon se ka element të konfliktit të interesit në dukje dhe se subjekti i rivlerësimit mund të kish deklaruar lidhur me të.

Lidhur me dy rastet e gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë ndërgjyqjese shoqërinë “****” sh.p.k.⁸⁹, nuk ndodhemi në kushtet e konfliktit në dukje pasi subjekti provoi bindshëm se ai nuk mund të kishte djeni lidhur me marrëdhënien juridike të trajtuar më lartë në këtë vendim.

Në vlerësimin të fakteve dhe të provave të rezultuara nga hetimi, Komisioni arriti në përfundimin se këto çështje nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

Denoncimet nga publiku

174. Në Komision janë depozituar 25 denoncime kundrejt subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj. Nga tërësia e këtyre denoncimeve rezultuan: (i) 3 denoncime të përsëritura; (ii) 11 denoncime janë drejtuar kundrejt disa subjekteve të rivlerësimit, ku përfshihet edhe subjekti Fatri Islamaj; (iii) 8 denoncime ndaj trupit gjykues, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti Fatri Islamaj; (iv) 1 denoncim drejtuar subjektit në cilësinë e relatorit; (v) 1 denoncim drejtuar subjektit për ndërhyrje në proceset gjyqësore, si dhe për vendim në shkelje të normave

⁸⁹ (1) Çështja gjyqësore, me palë paditëse shtetasen E. K., palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt: “zgjidhje kontrate sipërmarrjeje dhe kthim detyrimi”, për të cilën Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 29.10.2018; (2) çështja gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k., palë të paditur shoqërinë “****” etj., me objekt: “Detyrimin solidar të paditurve të përmbushin detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e nënsipërmarrjes dhe bashkinvestimit të datës 16.4.2009, me nr. ***, dhe të aktmarrëveshjes datë 30.1.2010, me vlerën 100.000 (njëqind mijë) euro, etj.”, për të cilën Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 19.4.2017.

procedurale; dhe (vi) 4 denoncime drejtuar subjektit në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1. Dy denoncime të shtetasit M. H., protokolluar në Komision: me nr. *** prot., datë 1.12.2017; dhe me nr. *** prot., datë 17.5.2018.

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim të padrejtë për arsye gjykimi në konflikt interesi. Denoncuesi ankohet për vendim të padrejtë për shkak të pjesëmarrjes së subjektit si anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, në rrethanat ku ka qenë edhe kryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë, në kohën kur ka paraqitur një kërkesë përjashtimi ndaj një subjekti tjetër, gjyqtar në këtë gjykatë.

2. Denoncim i shtetasit A. K. (oficer i policisë së shtetit), protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2018.

Konstatohet se denoncimi ka të bëjë me vendimin e marrë nga trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë (ku anëtar ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit), lidhur me ndryshimin e masës së sigurimit personal të të pandehurit B. Sh., i dyshuar për veprën penale “dhunë në familje”.

3. Denoncim i shtetasit A. K., protokolluar në Komision me nr. ***, datë 29.10.2018.

Ky denoncues ka pretenduar se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, në përbërjeje të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2018, ka cenuar të drejtat legjitime të tij, për arsye se ka favorizuar palën kundërshtare, e cila nuk ka prova ligjore për t’u mbrojtur.

Nga vlerësimi i këtij vendimi, konstatohet se denoncuesi ka kërkuar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 292, të Kodit të Procedurës Civile, sigurimin e provës, i cili lidhet me vendimin nr. ***, datë 13.4.2000, të ish-KKP-së, Qarku Tiranë, me qëllim për të mbrojtur të drejtat ligjore pasurore. Kjo gjykatë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe prova.

Në vijim, denoncuesi ka investuar Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vlerësim të këtij vendimi, duket se kjo gjykatë nuk ka shqyrtuar brenda kufijve të ankimit në përputhje me nenin 465, të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me pretendimin e mospasjes kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shqyrtimin e kërkesës për sigurim prove.

4. Denoncim i shtetasit A. S., protokolluar në Komision me nr. *** prot.

Ky shtetas ankohet se ka regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë një ankim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. *** akti, datë 13.2.2017, dhe se ky ankim nuk është shqyrtuar, edhe pse i ka paraqitur subjektit një kërkesë për përshpejtim gjykimi.

5. Denoncim i shtetasit A. K., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.2.2019.

Ky denoncim iu referohet 5 subjekteve të rivlerësimit që kanë shqyrtuar konfliktin e tij, midis të cilëve është edhe subjekti. Denoncuesi sqaron se në vitin 2018 ka investuar shoqërinë përmbaremore për ekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë. Për ekzekutimin e këtij vendimi, shoqëria përmbaremore ka kërkuar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë veçimin e pjesës takuese ndaj debitorit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj dhe prova. Duke mos qenë dakord, shoqëria përmbaremore ka ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit Tiranë, ankim i cili është shqyrtuar nga trupi gjykues i kësaj gjykate, ku subjekti ka qenë kryesues. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Denoncuesi ankohet se ky trup gjykues e ka shqyrtuar ankimin brenda dy muajve në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve dhe se ka pranuar një vendim gjykate, i cili ka tjetërsuar objektin e padisë së kërkuar.

Në vlerësim të fakteve të denoncuar, vendimit të gjykatës dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, rezulton se trupi gjykues ka shqyrtuar ankimin në përputhje me nenin 465, të Kodit të Procedurës Civile dhe pas shqyrtimit ka disponuar me vendim.

Lidhur me shqyrtimin e çështjes në një periudhë të shkurtër dhe në dhomë këshillimi, në referim të dispozitave ligjore procedurale civile, vihet re se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, ka respektuar ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile (me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017) që lidhen me shqyrtimin në dhomë këshillimi brenda një afati të shkurtër të çështjeve të kësaj natyre.

6. Denoncim i shtetasit D. T., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.4.2018.

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, ka dhënë një masë pezullimi në kushtet e konfliktit të interesit, pasi personi që e ka paditur e ka të njohur subjektin, për shkak të marrëdhënieve të punësimit në të njëjtin universitet, denoncim i cili sqarohet në vijim me denoncimin e mëposhtëm.

6.1 Denoncim vijues i shtetasit D. T., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.7.2018.

Denoncuesi D. T., në denoncimet e mësipërme, sqaron se gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës i policisë së shtetit është përballur me njerëz të cilët ka qenë të pushtetshëm dhe nuk e kanë lejuar të ushtrojnë detyrën. Në rastin që ai referon, sqaron se në datën 26.9.2017, gjatë ushtrimit të detyrës, ka vendosur një gjobë në një automjet dhe është përballur me kanosje të personave, të cilët ka qenë i detyruar t'i shoqërojë në polici. Personi që është shoqëruar ka qenë shtetasi R. Ç., pedagog në Universitetin e Tiranës dhe në disa universitete të tjera private, ku jep mësim dhe subjekti. Sipas tij, kjo ka bërë që subjekti të japë masën e pezullimit nga detyra, për shkak të akuzës që është ngritur ndaj tij dhe kolegut të tij për veprën penale “veprime arbitrare”.

7. Dy denoncime të shtetasit H. R., protokolluar në Komision: me nr. *** prot., datë 27.6. 2018; dhe me nr. *** prot., datë 18.12.2018.

Ky denoncim i është drejtuar një ish-subjekti rivlerësimi, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për mosvënien në dispozicion të një vendimi civil të arsyetuar brenda afateve ligjore. Denoncimi i referohet edhe 8 subjekteve të tjera për veprime korruptive në dhënien e drejtësisë, të cilat kanë gjykuar në trupa gjykuese për çështje civile pronësie, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Konkretisht, denoncuesi sqaron se ndaj subjektit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e tij si gjyqtar në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, me arsyetimin se ka qenë në konflikt interesi për arsye të lidhjeve të tij me ish-Kryeministrin Berisha, në çështjen me palë ndërgjyqëse: S. R., kundër F. K., etj., ku ka pasur interes gazetarja e fushatës elektorale e partisë demokratike, znj. A. K.

8. Denoncim i shtetasit S. R., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.2.2018.

Edhe ky denoncim trajton problematikat e çështjeve të tij të pronësisë me familjen K., dhe rrugët administrative të ndjekura lidhur me çështjen e tij. Në këtë denoncim referohen disa subjekte që kanë dhënë vendime lidhur me çështjet e tij (rreth 22 subjekte).

9. Denoncimi nr. *** , datë 12.2.2019.

Denoncuesi sqaron se ka kallëzuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda disa subjekte për shpërdorim detyre, por nuk shpjegon dhe as nuk provon cilat janë faktet dhe rrethanat që lidhen me shpërdorimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj. Në vlerësim të akteve, duket se ankesa i drejtohet një subjekti tjetër rivlerësimi (A.V.).

Nuk lidhet shënimi i emrit të subjektit, bërë në kartelën shoqëruese të këtij denoncimi, me faktet dhe rrethanat e pretenduara në denoncim.

10. Denoncim i shtetasit P. B., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.6.2018.

Denoncuesi pretendon se në procesin gjyqësor me palë paditëse, shoqëria “****”, përfaqësuar nga vetë denoncuesi dhe me palë të paditur shoqëria “****”, dega Shqipëri, me objekt “shlyerje të detyrimeve për prishje të kontratës, etj.”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga një subjekt tjetër rivlerësimi, ka abuzuar me të drejtën nëpërmjet zvarritjes së procesit gjyqësor, ku në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. ***, datë 3.4.2017, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë. Gjithashtu, denoncuesi ankohet edhe ndaj trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti ka qenë anëtar, për arsye se ka lënë në fuqi vendimin, duke i shkaktuar një dëm ekonomik.

11. Denoncim i shtetasit Sh. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.7.2018.

Ky denoncues referon te disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre përmendet edhe subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj. Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendim të padrejtë, duke i bashkëlidhur denoncimit dokumentacionin që lidhet me çështjen objekt gjykimi.

Në vlerësim të këtij dokumentacioni, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 24.3.2017, ka vendosur kthimin e kërkesës me nr. *** regj. them., datë 26.10.2016, së bashku me aktet shoqëruese, denoncuesit.

Kundër këtij vendimi, denoncuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka mbyllur gjykimin për shkak të mosprezencës së palëve të tjera në gjykim. Gjykata e Apelit Tiranë, në përfundim të shqyrtimit, e ka konsideruar të drejtë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e ka lënë atë në fuqi. Gjykata e Apelit Tiranë ka kryer analizë mbi shkaqet e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kthimin e kërkesës së bashku me aktet, ku bazuar në nenin 154, të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me paraqitjen e padisë me elementët e detyrueshëm që e përbëjnë atë, ka konstatuar të meta. Kjo gjykatë i ka lënë afat për plotësimin e të metave, nga ku ka rezultuar se denoncuesi nuk i ka plotësuar ato. Në këto kushte, kjo gjykatë e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12. Denoncim i shtetasës V. B., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.8.2018.

Denoncimi i referohet dy subjekteve të rivlerësimit. Denoncuesja ka hedhur dyshime se vendimi është marrë i ndikuar nga korrupsioni. Subjekti i ka bashkëlidhur denoncimit: (1) vendimin nr. ***, datë 25.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (2) vendimin nr. ***, datë 5.4.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe akte të tjera (ekstrakt i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe deklaratë noteriale datë 4.5.2015, lëshuar nga shoqëria).

Në vlerësim të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti ka qenë anëtar i trupit gjykues, vihet re se Gjykata e Apelit Tiranë është investuar mbi bazën e ankimit dhe e ka shqyrtuar në tërësi, ka analizuar në përputhje me Kodin e Procedurës Civile pretendimet e ankuesit dhe në përfundim ka disponuar me vendim.

13. Denoncim i shtetasit L. B., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.5.2018.

Sipas formularit të denoncimit, denoncuesi është ankuar ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, të cilët sipas tij kanë marrë vendime të padrejta. Në vlerësim të dokumentacionit që ka bashkëlidhur denoncuesi, rezulton se në datën 10.3.2008 subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka marrë një vendim (nr. ***). Duket se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në marrjen e këtij vendimi ka analizuar katër elementë të veprës penale: subjektin; anën subjektive; objektin; dhe anën objektive. Gjithashtu, ka vlerësuar edhe rrezikshmërinë e veprës dhe pasojat e ardhura të të dëmtuarit të

cilat janë të matshme në vlerën monetare. Gjykata, në analizë të të gjithë këtyre elementëve, në përfundim ka vendosur dënimin me burgim.

14. Denoncim i shtetasit Dh. N., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.3.2019.

Denoncuesi është ankuar ndaj disa subjekteve, duke hedhur dyshime për veprime korruptive në dhënien e vendimeve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Në vlerësim të të dhënave dhe rrethanave të paraqitura në këtë denoncim nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit.

15. Dy denoncime të shtetasit V. Ç., me të njëjtën përmbajtje, protokolluar në Komision: me nr. *** prot., datë 16.4.2019; dhe me nr. *** prot., datë 24.4.2019.

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje gjatë ushtrimit të detyrës administrative si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë – që kanë të bëjnë me zhdukjen e dy dosjeve penale lidhur me shtetasen C. Në vlerësim të denoncimit, nuk vlerësohet të ketë *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit.

16. Denoncim i protokolluar në Komision, me nr. *** prot., datë 25.3.2019.

Ky denoncim hedh dyshime se disa subjekte të rivlerësimit janë përfshirë në veprime korruptive, përfshirë këtu edhe subjektin e rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga verifikimi i këtij denoncimi vlerësohet se të dhënat dhe rrethanat e paraqitura nga denoncuesi nuk përbëjnë provë për rivlerësimin profesional të subjektit.

17. Denoncim i shtetasës R. Rr., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.7.2018.

Në këtë denoncim, subjekti referohet në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka trajtuar kërkesën për përjashtim gjyqtari ndaj një subjekti tjetër.

Nga verifikimi i denoncimit vlerësohet se të dhënat dhe rrethanat e trajtuara në këtë denoncim nuk përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin.

18. Denoncim i shtetasve M. T., dhe J. Zh., protokolluar në Komision me nr. ***, datë 21.6.2019.

Sipas formularit të denoncimit, denoncuesit ankohen për subjektin e rivlerësimit dhe për dy subjekte të tjerë, të cilët kanë gjykuar së bashku, me pretendimin se kanë shkelur provat me qëllim gjykimin e pandershëm për arsye përfitimi – duke injoruar disa vendime të mëparshme të formës së prerë, si dhe kanë gjykuar çështje të gjykuara më parë. Gjithashtu, sipas denoncuesve gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, është shtyrë mbi 10 herë për 9 muaj dhe se vendimi është i padrejtë, duke shkelur të drejtën e pronësisë.

19. Denoncim i shtetasit M. D., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.6.2019.

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer ndërhyrje të paligjshme dhe korruptive në proceset gjyqësore me palë denoncuesin. Z. M. D., ankohet konkretisht mbi vendimin nr. ***, datë 15.1.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit.

Denoncuesi bashkëlidh rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ku kërkon prishjen e vendimit nr. ***, datë 15.1.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, por nuk bashkëlidh vendimin nr. ***, datë 15.1.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në rekurs z. M. D., shprehet se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka shkelje procedurale, pasi nuk ka respektuar procedurën e njoftimit të parashikuar nga neni 460.

Nga kërkimi *online* në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja është regjistruar më 5.4.2018 dhe është caktuar relatori në Gjykatën e Lartë.

Komisioni, për nevoja të hetimit, i ka kërkuar Gjykatës së Lartë dosjen gjyqësore për të shqyrtuar nëse ekzistojnë pretendimet e denoncuesit. Gjykata e Lartë⁹⁰ dërgon kopjen e dosjes gjyqësore objekt hetimi – nga shqyrtimi i së cilës rezultoi se në dosje nuk gjendet shpallja e Gjykatës së Apelit Tiranë mbi njoftimin për ditën dhe orën e gjyqimit.

Sipas pikës 2, të nenit 465/a, të Kodit të Procedurës Civile, për gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë, në dhomë këshillimi “*Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin e përmbledhur dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve, sipas nenit 460, të këtij kodi, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes.*”

Nga vendimi nr. 12, datë 15.1.2018, i Gjykatës së Apelit Tiranë vihet re se subjekti ka qenë anëtar i trupit gjykues dhe jo kryetar i trupit gjykues.

20. Denoncim i shtetasit A. Z., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.6.2019.

Sipas formularit të denoncimit, denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe për dy subjekte të tjerë, ndër të tjera për procedurën e ndjekur në dhënien e vendimit nr. ***, datë 22.5.2019, pasi sipas tij nuk është bazuar në veprime ligjore për marrjen e këtij vendimi.

21. Denoncim i shtetasës R. Rr., protokolluar në Komision me nr. ***, datë 17.7.2019.

Sipas formularit të denoncimit, denoncuesja ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe për tre subjekte të tjerë, pasi kanë dhënë një vendim të paramenduar, të përkohshëm dhe të qëllimshëm. Znj. R. Rr., bashkëlidh kallëzimin e datës 24.6.2019, drejtuar Prokurores së Përgjithshme dhe ONM-së, ku subjekti kallëzohet si anëtar i trupit gjykues për gjykim të njëanshëm dhe të qëllimshëm, pasi nuk kanë pranuar kërkesën e denoncueses për përjashtimin e gjyqtarës V. H.

Nga një denoncim që ka bërë shtetasja R. Rr., edhe për subjekte të tjera të rivlerësimit Komisioni informohet se me vendimin datë 4.7.2019, z. N. T., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin e kallëzuar nga shtetasja R. Rr., e cila kishte kallëzuar shtetasit Fatri Islamaj, A. V., dhe R. H., për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, pasi nuk kanë pranuar kërkesën e znj. R. Rr., për përjashtimin e gjyqtarës V. H.

175. Nga vlerësimi në përgjithësi i denoncimeve Komisioni nuk konstatoi elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe që lidhen me etikën apo aftësitë profesionale të tij të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Komisioni vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni, bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

⁹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 5.7.2019.

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 10.12.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues
Lulzim Hamitaj
(kundër)

Relatore
Valbona Sanxhaktari

Anëtare
Pamela Qirko

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro